



PRESIONI PRODUKTIV

Jeta në një mjedis në të cilin madhërohet Allahu dhe zbatohen dispozitat e Sheriatit të tij, ka qenë, është dhe do të jetë preferencë e muslimanëve. Ata si bashkësi janë të detyruar të krijojnë një bashkësi në të cilën rregullimi i jetës shoqërore dhe i asaj individuale do të drejtohet me parimet e shpalljes hyjnore. Rrethanat e këtilla janë kushte ideale për zbatimin e detyrës së mëkëmbësit në tokë që e ka lloji njerëzor. Por një mjedis i tillë jo çdoherë është i mundshëm. Në shumë periudha të historisë, e në veçanti sot muslimanët janë të detyruar të jetojnë në shoqëri që anashkalojnë, madje edhe luftojnë parimet e sistemit hyjnor të rregullimit shoqëror. Të jetuarit në rrethana të tilla, për muslimanët, është një sfidë e vërtetë, në shumë raste edhe e dhimbshme. Në atë mjedis ata ballafaqohen me luftë të hapur dhe të fshehur ndaj Islamit, me projekte që synojnë zhveshjen e muslimanëve nga gjitha elementet e identitetit Islam etj. Atë që gjithashtu dua ta nënvizoj është edhe fakti se jeta e tyre është edhe një mundësi e madhe. Shpeshherë gjatë historisë presionet dhe imponimet kanë qenë iniciues të formave të ndryshme, origjinale dhe kreative të veprimtarisë Islame. Po të mos ishte lufta e kolonializmit francez ndaj gjuhës arabe, nuk do të dilte në shesh vepra madhështore e nënave myslimane që shtëpitë e tyre i shndërruan në shkolla ku u ruajt gjuha e Kuranit. Po të mos ishte lufta e pamëshirshme e sistemit komunist në Uzbekistan, nuk do të krijohej sistemi i dhomave në të cilat fshehurazi, natën mësohej feja. Edhe muslimanët shqiptar, me mejtepet e tyre në të cilët, gjatë komunizmit, mësohej Kurani dhe parimet e fesë, janë provë se shpeshherë gjatë vështirësive gjinden modele të suksesshme të veprimtarisë që ndoshta japin rezultate që vështirë arrihen edhe në momentet e rahatisë së plotë. E tillë është situata edhe sot. Në momentet kur veçanërisht tek shqiptaret mundohet të krijohet dhe të promovohet ideja se me Islam ardhmëria jonë kombëtare është e rrezikuar, ne muslimanët duhet të angazhohemi, duke e shfrytëzuar klimën e presionit për një angazhim të frytshëm. Në këtë klimë të presionit ne duhet të hapemi drejtë shoqërisë, me krenari t'i parashtrijmë bindjet tona duke u angazhuar në projekte që ndikojnë në rritjen e mirëqenies së përgjithshme. Nëse, katolikofilët, thirrësit e lajthitjes ideologjike dhe morale, të degjeneruarit nuk kanë drojë të dalin dhe të luftojnë në mënyra të ndryshme për realizimin e synimeve të tyre, neve muslimanëve nuk na mbetet kohë për të hezituuar. Duhet ta rikthejmë vullnetin për punë dhe aspiratat për arritje të larta, duke ia kujtuar vetvetes faktin se drita e Allahut asnjëherë nuk do të shuhet. Sa nxitje të bukur kemi prej Allahut i cili thotë: **“Ata dëshirojnë të fikin dritën e Allahut me gojën e tyre, por Allahu e përsos dritën e Vet, edhe nëse (këtë gjë) e urrejnë jobsimitarët. Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët.”** (Saff, 8-9).

E vërteta është kjo, e sa jemi të bindur në këtë të vërtetë le të dëshmojnë veprat tona.

Allahut i takon dija absolute.

Në emër të redaksisë: Mr. Talha Kurtishi

AKTUALE

**3-7 | POLICIA E KOSOVËS USHTROI DHUNË MBI
MYSLIMANËT**

**8-12 | IZRAELITË DUAN HAPJEN E NJË “FAQEJE TË RE”
ME TURQINË**

13-15 | BLIC LAJME

SFIDA

16-18 | ALTERNATIVAT ISLAME

AKIDE

19-22 | FUQIZIMI I VETËDIJES SË MBIKËQYRJES

DRITARE

23-26 | HALLI I MEDIËS ISLAME

**26-27 | NUK DO TË KISHTE INTERNET
PA EL-HAVARIZMIN**

28-31 | NUK KA ISLAM PA NJË XHEMAT

29-34 | MBIJETESA NË TRI FAZA

FIKH

**34-37 | PENDIMI NGA PËRFITIMI I PASURISË NË MËNYRË
TË PALIGJSHME (1)**

EKONOMI

38-41 | KONTRATA E MIRËMBAJTJES DHE E RIPARIMIT

FAMILJA

42-45 | NË MENDJEN E FËMIJËS MUSLIMAN

HADITH

46-51 | KËSHTU NËNSHTROHET DYNJAJA

THESARE

52-55 | DEKODIMI SHKENCOR I KURANIT

FETVA DHE KONSULTIME

**56-60 | UDHËZIME NË RAST SITUATASH PROBLEMATIKE
PËR MUSLIMANIN**

REDAKSIA

Kryeredaktor: Omer BERISHA

zv. kryeredaktorë: Agron TERZIQI dhe Justinian TOPULLI

Anëtarë të redaksisë:

Ismail BARDHOSHI, Bledar HAXHIU, Lulzim SUSURI, Talha KURTISHI, Genc PLUMBI,
Ali SHABANI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Llokman HOXHA, Rashit ZYLFIU dhe Hajrush MANI

Bashkëpunëtorë: Ahmed KALAJA, Ekrem AVDIU dhe Enis RAMA

Redaktor gjuhësor: Roald HYSA

Ballina: Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio)

Shpërndarje & marketing: Gazmend Zeneli

Boton: AlbIslam

Adresa: rr. Petre Georgiev nr. 63 | Çair | Shkup 1000
e-mail:

albislam@albislam.com

albislam@gmail.com

sms: +389 71 806 114 | fax&tel: +389 2 26 12 932

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR
Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOËL

xhirollogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denarë)

xhirollogaria: 0270100245547

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro etj.)

Rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T.: KOBBSMK2X

IBAN: MK07300701002455425

numri tatimor: 4030008038784

POLICIA E KOSOVËS USHTROI DHUNË MBI MYSLIMANËT

SHKRUAN: BUJAR ISMA

Prishtinë, qershor, 2011.

Policia e Kosovës ka përdorur dhunë ndaj besimtarëve mysliman, të cilët po bënin lutjet e xhumasë në rrugë në shenjë pakënaqësie për mos hapësirën e mjaftueshme për kryerjen e obligimeve fetare. Madje besimtarët u keqtrajtuuan edhe gjatë faljes së namazit, duke mbetur disa të lënduar dhe dy të arrestuar të cilët më vonë u liruan.

Orët e mesditës së datës 17 qershor ishin mjaftë sfiduese për besimtarët mysliman, të cilët kanë vazhduar me shprehjen e pakënaqësive të tyre, përkatësisht për mungesën e një qendre të madhe islame në Prishtinë. Këto pakënaqësi ata i shprehën duke falur namazin e xhumasë brenda dhe jashtë

xhamisë së Çarshisë, që gjendet afër Parlamentit të Republikës së Kosovës. Të premtën e parë gjithçka shkoi siç ishte paraparë, por kjo nuk vazhdoi shumë gjatë. Një javë më vonë, më saktësisht më 24 qershor, besimtarët nuk u lejuan që të vazhdojnë këto aktivitete. Ata u penguan nga policia e shpeshtuar e Kosovës, të cilët në mënyrë mjaftë të dhunshme torturuan besimtarët mysliman dhe atë duke qenë në namaz. E gjithë kjo dukej sikur është rikthyer koha e vuajtjeve të viteve të 90-ta, dukej sikur komunizmi përforcoi rrënjët të cilët kishin filluar të thahen. Pikërisht ishte Policia e Kosovës që provokoi besimtarët, nuk lejoi që ata në mënyrë paqësore të shprehin pakënaqësitë e tyre. Vazhduan fjalimet, vazhduan sharjet nga “ruajtësit” e rendit, ndërsa myslimanët vazhduan të durojnë e të durojnë, ngase në çdo moment u kujtohej fjala e Zotit që Ai



është me të durueshmit. Ndërsa xhemati sa vinte e shtohet gjithnjë e më shumë krahasuar me një javë më parë, por shtohet gjithashtu edhe numri i patrullave policore, duke penguar xhematin që të afrohen në vendin e caktuar. Përkundër kësaj besimtarët arritën të ulen në mes të udhëkryqit, ndërsa policia kërkoi që ata të lirojnë rrugën njëanëshe, me arsyetimin se mund të paraqitet nevoja që të kalojnë autoambulancat emergjente. Edhe këtë pranuan qytetarët, disa prishën namazin e disa pritën deri në fund e më pas u larguan. Ndërsa “provokuesve” nuk u mjaftoi kjo, u kuptua se nuk ishte qëllimi i emergjencës, por në mënyrë mizore të marrin gjithë rrugën, duke u thënë besimtarëve që të hyjnë brenda në xhami, e kështu harruan qëllimin e protestimit të këtyre të fundit.

U "ndal" ezani....

Myezini i moshuar i xhamisë filloi të thërriste ezanin, por më kot, iu ndërpre në gjysmë nga ndërhyrja e pamëshirshme e policisë, që pas shumë okupimeve të mëhershme, u ndal ezani edhe në vendin tonë për shkak të kërkesave të njëpasnjëshme që kishin policët gjatë protestës. Besimtarët tashmë humbën durimin, u ngritën në këmbë për të ndaluar një terror të tillë. Thirri edhe një herë ezani deri në fund. Teksa imami filloi ligjërimin, provokimet sa vinin e shtoheshin nga ana e Uniformës blu të Kosovës, ndërkaq radiolidhjet policore u shpeshtuan, që qarkullonin fjalët e policisë **” Janë duke bërë sexhde, tu fal një mas e madhe, një numër i madh duhet të**



arrestohen. Forcat e njësitit special nuk mjaftojnë, nevojiten përforcime. Intervenimi ka qenë i pamundur, jemi në koordinim për të PROVUAR prapë”, ndërsa kombi-busi policor priste i hapur për t’u mbushur me të arrestuarit, kësaj radhe me ata të cilët ishin duke i rënë në sexhde Zotit të madhërisëm. Shpejt e shpejt u fal namazi i xhumasë të cilin nuk arritën ta kryejnë të gjithë besimtarët, duke u munduar ta mbrojnë xhematin dhe të stabilizojnë situatën që po e prishte “milicia” e Kosovës laike e demokratike. Sidoqoftë, përkundër këtyre përpjekjeve shumë kokat e besimtarëve mysliman u shkelën e u grushtuan nga këta pjesëtarë policorë që ruajnë “sigurinë” në Kosovë. Tashmë situata u përkeqësua akoma edhe më shumë, ngase synimi i “milicisë” është

arrestimi i organizatorit Fuad Ramiqi. E kapën në mënyrë të fshehtë, por kur xhemati kuptoi e tërhoqën me forcë nga dora policore. Ndërkaq dy të arrestuar të tjerë u dërguan në qendrën policore, e njëri prej tyre ishte edhe H.H që rrëfen për vuajtjet dhe rrahjet që i përjetoi deri atje. Ai thotë se është rrahur deri sa ka mbetur

“Përkundër këtyre përpjekjeve shumë kokat e besimtarëve mysliman u shkelën e u grushtuan nga këta pjesëtarë policorë që ruajnë “sigurinë” në Kosovë...”



pa vetëdije ndërsa këtë e dëshmuar edhe shenjat në trupin e tij. Sidoqoftë organizatorët kërkuan nga xhemati që të shpërndaheshin, në mënyrë që situata të mos përkeqësohej edhe më shumë.

Ramiqi- s'duam kazino, por duam xhami

Organizatori i kësaj proteste paqësore, Fuad Ramiqi ka thënë së qeveria e vendit duhet të merr parasysh sa më shpejt kërkesat e këtij komuniteti, në mënyrë që besimtarët të kenë më shumë hapësirë për të kryer ritet e tyre fetare. “Nuk po kërkojmë punë dhe ngritje pagash e as parcela për kazino, por po kërkojmë një

vend për të ndërtuar një xhami të madhe që do të plotësonte nevojat tona”, u shpreh Ramiqi duke thënë se nuk do të ndalen deri sa të plotësohen kërkesat e besimtarëve.

Tërnavë ndërhyr në debat, demanton policinë

Disa orë më vonë, KlanKosova ftoi në studio dy të ftuar, Fuad Ramiqin organizator i protestës, dhe Rexhep Sijarina, zëvendës drejtor policor për rajonin e Prishtinës. Gjatë një debati mjaft të ngjeshur, nga zyrtari policor u tha se ndërhyrjet policore ishin të drejta, pasi që siç tha ai, protesta nuk është përkrahur as nga Bashkësia Islame e Kosovës, duke

thënë se kanë kontaktuar disa herë me BIK-un për këtë çështje. Mirëpo, jo më kot thotë populli “gënjeshtër i ka këmbët e shkurtra”. Nuk shkoi shumë gjatë, fjalët e Sijarinës u demantuan nga myftiu i Kosovës Naim Tërnavë, i cili telefonoi KlanKosovën dhe kërkoi që të ndërhyjë në këtë debat. Tërnavë gjatë telefonatës tha se policia e Kosovës nuk kishte kontaktuar asnjëherë me BIK-un.” asnjëherë askush nga Policia e Kosovës nuk ka kontaktuar me bashkësinë islame”, përsëriti disa herë myftiu duke thënë se ai është në kontakt të vazhdueshëm me kryetarin e komunës së Prishtinës Isa Mustafa, e ky i fundit kishte premtuar se brenda dy javëve do të merrej parasysh kërkesa e BIK-it. Myftiu Tërnavë, zbuloi po ashtu edhe vendin ku BIK-u kërkon të ndërtojë xhaminë e madhe, që do të ishte trualli pranë Institutit albanologjik, në qendër të Prishtinës, rreth 200 metra larg katedrales. Ndërsa komuna e Prishtinës pas dy dite nxori propozimin që do ta hedh në votim dhe diskutim publik, e ky vend do të ishte çerdhja përball institutit albanologjik. Se a do të jetë ky vendi i qendrës së madhe islame do të kuptohet në fund të korrikut u tha nga zyrtarët komunal prishtinas.

Reagimi i Forumit të myslimanëve të Kosovës – ndërhyrja e policisë ishte politike

Dy ditë më vonë reagoi edhe Forumi i myslimanëve të Kosovës, me në krye po ashtu Fuad Ramiqin, që konsideron se ndërhyrja e policisë ka qenë politike. “Edhe pse kemi qenë të interesuar dhe në çdo formë kemi tentuar të pamundësonim një veprim të tillë, ndërhyrjen e policisë së Kosovës, dhe kemi qenë edhe për kompromis, që vetëm të falet farzi i

“Myftiu Tërnavë, zbuloi po ashtu edhe vendin ku BIK-u kërkon të ndërtojë xhaminë e madhe, që do të ishte trualli pranë Institutit albanologjik, në qendër të Prishtinës, rreth 200 metra larg katedrales...”

namazit të xhumasë, dhe të bëhet shpërndarja e xhematit, për dallim nga java e kaluar, tani policia e Kosovës, me urdhër nga strukturat politike udhëheqëse komunale apo qendrore, ka ndërhyrë në mënyrë brutale, dhe falë angazhimit tonë maksimal kemi arrit që të parandalojmë një eskalim më të gjerë të dhunës.”, thuhet në komunikatë. Po ashtu reagoi edhe një herë Bashkësia Islame e Kosovës si dhe Partia e Drejtësisë, të cilët ndërhyrjen e policisë e konsideruan si të padrejtë.

Sido që të jetë, grushtimet dhe torturimet u mbetën në xhep policisë së Kosovës. Kjo është protesta e dytë paqësore që është mbajtur me faljen e xhumasë në rrugë.. Mirëpo kjo nuk është hera e parë që protestojnë myslimanët kosovarë, vitin e kaluar janë mbajtur dy protesta të mëdha paqësore me mbi 15 mijë protestues kundër vendimit të Ministrisë së Arsimit, për heqjen e mbulesës së femrave myslimane nëpër shkolla të mesme, protesta këto që nuk rezultuan me rezultate pozitive akoma. Për ndryshe 95% e popullatës kosovare përbëhet prej myslimanëve. ■



IZRAELITË DUAN HAPJEN E NJË “FAQEJE TË RE” ME TURQINË

zhvillimet e fundit që ka dëshmuar Turqia, në lidhje me sistemin qeverisës apo në politikën e saj të brendshme, të bëjnë të kuptosh se Turqia dëshiron të transformohet në një fuqi të madhe rajonale, gjë të cilën e ndihmon edhe pozita e saj gjeografike. Nëse SHBA do të dalë nga Iraku, atëherë mejdani do të jetë tërësisht bosh para Perandorisë së re Osmane.



AHMED BEHNISI

Pas fitores së Erdoganit dhe partisë së tij në zgjedhjet legjislative që u zhvilluan më 13 Qershor shumë zëra izraelitë bënë thirrje për domosdoshmërinë e krijimit të marrëdhënieve të mira me Turqinë, në mënyrë të atillë që t'i shërbejnë interesave izraelite në rajon dhe sidomos në përballjen e Izraelit me Iranin. Gjithashtu në shumë artikuj janë komentuar ambiciet e Erdoganit për të ringjallur Perandorinë Osmane, që e ka udhëhequr botën islame dhe kjo nëpërmjet ndryshimit të kushtetutës për t'i shtuar asaj disa tipare islamike, që e

dallojnë nga kushtetuta laike dhe nëpërmjet ndryshimit të sistemit drejt një sistemi presidencial që i jep atij mundësinë për të ecur në drejtim të ideve dhe koncepteve të tij.

Përveç kësaj shtypi izraelit ka trajtuar krijimin e marrëdhënieve të reja që lidhin Asadin me Erdoganin, që kanë të bëjnë me largimin e Turqisë nën udhëheqjen e Erdoganit nga Asadi dhe regjimi i tij dhe duke hedhur shikimin drejt një regjimi të ri në Siri në të ardhmen.

Një iniciativë e re

Shumë shkrime të ndryshme izraelite kanë bërë thirrje drejt një domos-

doshmërie që është krijuar në lidhje me “hapjen e një faqeje të re” në marrëdhëniet me Turqinë pas fitores së Erdoganit në zgjedhjet legislative, duke vënë theksin në shumë shkaqe dhe faktorë që qëndrojnë pas rëndësisë së madhe që ka rikthimi i aleancës turko-izraelite, e cila ka qenë prezente në periudhën para Erdoganit.

Në një artikull që mbante titullin “Një iniciativë e re me Turqinë” më datë 15 Qershor në gazetën “Israel Hajoum” Jusi Belin vë theksin se është e domosdoshme, që Izraeli të punojë për interesat madhore kombëtare dhe të rishikojë edhe një herë me seriozitet marrëdhëniet e tij me Ankaranë, sepse bota nuk është e ndërtuar mbi bazat e marrëdhënieve reciproke, por është ndërtuar mbi bazat e interesave. Për këtë arsye Izraeli duhet të bëjë më shumë për t’u afruar më Turqinë.

Belini e arsyeton këtë gjë, duke theksuar faktin se demokracia turke është ajo me më shumë rëndësi në botën islame (përkrah Indonezisë) dhe se Izraeli duhet që të ndërtojë marrëdhënie të mira me Turqinë pasi Egjipti i ktheu shpinën Izraelit pas rënies së Mubarekut dhe në kushtet kur Irani konsiderohet një armik i përbetuar i Izraelit që nga vitet 70’. Në këtë mënyrë Izraeli nuk ka përpara alternativë tjetër përveç aleancës me Turqinë edhe një herë tjetër.

Autori shton se me Turqinë duhet të ulemi për të biseduar për të koordinuar qëndrimet dhe kjo nuk përbën nënshtrim dhe dorëzim për Izraelin. Përkundrazi kjo është një përpjekje për t’i kuptuar çështjet

“...Ai që do të paguajë më shtrenjtë çmimin e ndryshimit të kushtetutës në Turqi do të jetë Izraeli...”

në thellësi. Gjithashtu ambasadori turk duhet të kthehet në Izrael dhe turqit duhet të pranojnë emërimin e një ambasadori të ri izraelit.

Autori e mbyll artikullin duke theksuar se partia e Erdoganit nuk arriti që në këto zgjedhje të merrte një shumicë dërrmuese që arriti të merrte në zgjedhjet e shkuara. Si e tillë është e dyshimtë që ai të realizojë ëndrrën e tij për ta transformuar Turqinë në një vend ku sundon presidenti, apo që të kandidojë për këtë post të kërkuar për shumë vite në të ardhmen.

Si rrjedhojë, është e mundur që pasi të kthehet në realitet Erdogani do të ketë nevojë edhe një herë tjetër, që të ndërtojë marrëdhënie të mira me Izraelin dhe në këtë mënyrë qeveria izraelite do të arrijë lehtësisht që të gjejë një koordinim të ri në marrëdhëniet mes dy vendeve, zhvillim i cili përbën interes turk, por po ashtu edhe izraelit.

Doktor Chilo Rozenberg, në artikullin e tij të datës 13 Qershor, thekson se Turqia përbën alternativën e vetme të mundshme para Izraelit në përballjen e tij me Iranin, i cili ndjek një medh’heb shumë fanatik të Islamit dhe ngre parulla për zhdukjen e SHBA dhe të botës perëndimore, duke konfirmuar kështu se ky përbën shkakun kryesor që e nxit Izraelin për të gjetur një

rrugë pajtimi me Turqinë dhe për të përmirësuar marrëdhëniet e tij me të pas fitores së Erdoganit në zgjedhje.

Autori shton se zhvillimet e fundit që ka dëshmuar Turqia, në lidhje me sistemin qeverisës apo në politikën e saj të brendshme, të bëjnë të kuptosh se Turqia dëshiron të transformohet në një fuqi të madhe rajonale, gjë të cilën e ndihmon edhe pozita e saj gjeografike. Nëse SHBA do të dalë nga Iraku, atëherë mejdani do të jetë tërësisht bosh para Perandorisë së re Osmane.

Autori e mbyll artikullin e tij duke konfirmuar faktin se Izraeli duhet të shpejtojë për të bërë hapa përpara në afrimin e tij me Turqinë dhe të ndalet para çdo hapi që shkakton zemërimin “e forcës së madhe në rritje”. Izraeli duhet të gjejë kanalet e përshtatshme për të mbërritur në zemrën e institucionit mbizotërues në Turqi. Sa më shumë të qëndrojnë Turqia përkrah Izraelit, aq më mirë do të ishte për këtë të fundit.

Ndryshimi i kushtetutës

Vihet re që analizat izraelite janë marrë me fitoren e Erdoganit në zgjedhjet turke dhe me dëshirën e këtij të fundit për të ndryshuar kushtetutën në atë formë, që do të bënte të mundur ndryshimin e imazhit dhe themelit të pushtetit në Turqi (e cila konsiderohet një shtet laik), në mënyrë që të jetë e mundur që të transformohet në një vend islamiko- demokratik, gjë e cila do të ndikonte negativisht mbi Izraelin.

Autorja Jalja Lindshtoras në artikullin e

saj, që u botua në Qendrën Kërkimore Izraelite të Sigurisë Kombëtare më datë 13 Qershor me titull “Erdogani, por i kushtëzuar” vë theksin në faktin se Erdogan ka dëshirë të fusë reforma dhe korrigjime të shumta në kushtetutën turke deri në atë masë, që i shërben ideologjisë së tij dhe që i jep fesë një rol më të madh në jetën politike dhe ditore të vatanit turk.

Ajo parasheh se pavarësisht se votimet turke përqendroheshin më tepër në çështjet e brendshme, dëshira e Erdoganit ishte që ndryshimet të bëheshin për qëllime të jashtme. Revolucionet arabe dhe ndikimet e tyre të njëpasnjëshme në situatën e Lindjes së Mesme dhe në normalizimin paqësor të konfliktit arabo-izraelit e shtynte Erdoganin dhe partinë e tij për të formuluar një kushtetutë të re, që i jepte mundësinë për ta afruar shtetin e tij me regjimet islamike të reja që janë në ngjitje e sipër në vendet e prekura nga revolucionet.

Nga ana e tij profesor Ijal Sizer, në artikullin e tij në “Israel Hajoum” të botuar më datë 12 Qershor mendon se ai që do të paguajë më shtrenjtë çmimin e ndryshimit të kushtetutës në Turqi do të jetë Izraeli, duke e shpjeguar këtë me faktin se Erdogani e dëshiron ndryshimin e kushtetutës, në mënyrë që të ketë mundësi të ndryshojë sistemin e qeverisjes duke e kthyer atë në një sistem presidencial ashtu si në SHBA. Në këtë mënyrë pas një ose dy vjetësh Erdogani do të konkurrojë për të arritur postin e presidentit, duke u kthyer në udhëheqësin e Turqisë pa asnjë kontestim apo kusht.

Autori mendon se sukcesi i Erdoganit në këto zgjedhje do t'i japë atij mundësinë për ta ndryshuar kushtetutën në përputhje me vizionin e tij dhe të partisë së tij, parisë së "Drejtesisë dhe Zhvillimit". Baza e këtij vizioni është ndarja nga trashëgimi i themeluesit të Turqisë moderne të Ataturkut laik dhe përkrahës i Perëndimit, duke e kthyer këtë shtet në një vend islam, që e sheh shtetin osman si shembull të inspirimit dhe të fuqisë së saj.

Sizeri shton se Erdogani ka pasur sukses në dobësimin e forcës së ushtrisë dhe të dimensioneve të tij politike, një institucion ky që për vite me radhë ka përfaqësuar mbrojtësin e laicizmit ataturkist në Turqi. Gjithashtu Erdogani ka arritur të dobësojë shumë forcën e të gjitha elitave laike në Turqi, të cilat kanë luftuar me forcë deri në këto momente në mbrojtje të Turqisë, si një vend laik, që ka hedhur shikimin te Perëndimi dhe dëshiron që të bëhet pjesë e pandarë e Evropës. Autori mendon se ndryshimi i kushtetutës bëhet për t'i dhënë Turqisë një ngjyrë islamike pas së cilës Erdogani synon që ta kthejë Turqinë një fuqi rajonale që gëzon një përkrahje të gjerë në vendet arabe dhe islame, gjë e cila e bën Izraelin të ndihet i shqetësuar dhe tepër i kujdesshëm. Për këtë autori jep një shembull për të vërtetuar se Turqia pas fitores së Erdoganit nuk ka ndërmend të qëndrojë duarlidhur në konfliktin mes regjimit laik të Beshar Asadit, që ndihmohet nga regjimi shi'it (Irani dhe Hizballahi) dhe opozitës së këtij regjimi që i përkasin rrymës sunitë nën udhëheqjen e

"Vëllazërisë Muslimane". Për sa i përket qëndrimit të partisë së Erdoganit, "Vëllazëria muslimane" konsiderohen shumë të rëndësishëm kudo që të ndodhen, në Palestinë (Hamasi) apo në Siri, sepse ata janë vëllezër në doktrinën e tyre dhe aleatë politikë në të ardhmen.

Erdogani dhe Asadi

Gazeta izraelite Haretz e datës 16 Qershor thekson se Siria ka zënë vendin e Gazës në listën e përparësive të Erdoganit dhe të partisë së tij në pushtet dhe shton se Erdogani parashikon dërgimin e disa goditjeve të fuqishme të regjimit të Asadit mbi zonat kurde në Siri, në mënyrë të atillë që kurdët e Sirisë të emigrojnë në brendësi të Turqisë dhe t'i bashkëngjiten bashkëatdhetarëve të tyre në Turqi, të cilët i dhanë një goditje të fortë Erdoganit në zgjedhjet e fundit.

Gazeta thekson se Asadi është kthyer në kohët e fundit nga një mik i ngushtë në një person të padëshirueshëm për Turqinë, për shkak se Turqia është më se e sigurt se ajo nuk mund të ketë pozita të forta vetëm nëse mbështet revolucionet arabe, duke synuar kështu marrjen e udhëheqjes së botës islame në të ardhmen. ■

TAKIM ME PROFESORËT E UNIVERSITETIT ISLAMIK TË MEDINËS

Sapanxha, Turqi. Në kuadër të kujdesit që ka Universiteti Islamik – Medinë për studentët e saj edhe pas përfundimit të studimeve, organizoi një takim pesëditësh me studentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Turqia si dhe shtete të tjera me moton: “Mbrotjtja nga rreziqet aktuale kundër Islamit”. Kishte trajtime të temave të rëndësishme nga ana e profesorëve ndërsa secili pjesëmarrës referoi duke folur për punën që ka bërë dhe po bën në vendin e tij, duke lënë hapësirë që ai aktivitet të diskutohet nga ana e profesorëve dhe pjesëmarrësve tjerë. ■

SERBIA OFRON AZIL PËR MUAMER GADAFIN

Diplomatë të vendeve anëtare të NATO-s i kanë garantuar sigurinë Muamer Gadafit dhe anëtarëve të tjerë të familjes së tij, për azil në Serbi, me kushtin që ai të tërhiqet nga pushteti. Siç bën të ditur gazeta serbe `Blic`, oferta është bërë nga ambasadorët e NATO-s, nëse Gadafi vendos të braktisë Libinë. Nuk ka qëndrim zyrtar nga Serbia, edhe pse Gadafi ka një lidhje me këtë shtet; në moshë të re pati studiuar në Beograd.

TURQIA PARALAJMËROI IZRAELIN QË TË MOS PËRSËRISË GABIMIN E VITIT TË KALUAR

Turqia e paralajmëroi Izraelin, që të mos përsërisë gabimin që bëri vitin e kaluar kur sulmoi flotën që transportonte ndihma për palestinezët në Rripin e Gazës, duke vrarë 9 aktivistë humanitarë, shtetas turq. Fondacioni për ndihma humanitare, me seli në Turqi, muajin e ardhshëm po planifikon që përsëri me anije, të dërgojë ndihmë për palestinezët në Rripin e Gazës. Izraeli ndërkohë ka paralajmëruar sërish, se do të ndalë karvanin e ndihmave, me dyshimin se në këtë mënyrë i dërgohen armë Hamasit radikal. ■

EKSTRADOHET RATKO MLLADIQ

Autoritetet serbe kanë ekstraduar ish-gjeneralin e serbëve të Bosnjës Ratko Mlladiq në Tribunalin e Hagës, ku do të përballet me akuzat për gjenocid, krime të luftës dhe akuza të tjera që rrjedhin nga roli i tij në luftërat e Ballkanit në vitet '90-të. Mlladiq ka kaluar afër 16 vjet në arrati, para se të kapej më 26 maj në një fshat verior serb. I arratisuri më i kërkuar i Tribunalit të Hagës, akuzohet për gjenocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit për shkak të rolit që luajti në vrasjen e rreth 8 mijë burrave dhe djemve myslimanë në Srebrenicë, si dhe për rrethimin e përgjakshëm katërvjeçar të Sarajevës. Masakra e Srebrenicës e vitit 1995 konsiderohet të ketë qenë masakra më e rëndë e kryer në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. ■

FITON ERDOGANI, HYN NË HISTORI

Sipas rezultateve në zgjedhjet parlamentare në Turqi ka triumfuar Partia e Drejtësisë dhe Zhvillimit (AKP) e kryeministrit aktual Rexhep Tajip Erdogan me 50,3% njoftojnë mediet turke. Televizioni CNN Turk bën të ditur se partia opozitare e qendrës së majtë, Partia Republikane-Popullore ka fituar 25,91%, ndërsa Partia e Aksionit Nacional ka marrë 13,03% të votave. Partia e Erdoganit në këtë mënyrë ka fituar 3 herë me radhë duke e rritur numrin e votave. Në zgjedhjet e vitit 2002, AKP ka fituar 34.28 % të votave, në 2007 me 46.58 % ndërsa në zgjedhjet e fundit ka kaluar 50%. ■

BEN ALI DHE GRUAJA E TIJ DËNOHEN ME 35 VJET BURG

Një gjykatë tuniziane vendosi të dënojë ish-presidentin tunizian Ben Ali dhe gruan e tij, në mungesë, me nga 35 vjet burg secili. Ata u deklaruan fajtorë për vjedhje dhe zotërim të jashtëligjshëm të parave dhe bizhuterive. Vendimi i lexuar në sallën e gjyqit thotë se Ben Ali dhe gruaja e tij duhet të paguajnë një gjobë prej 91 milionë dinarësh tunizianë (65,6 milionë dollarë). Gjyqtari tha se vendimi tjetër për akuzat e tjera si mbajtje e drogave dhe armëve pa leje do të jepet më 30 qershor. Çifti presidencial u largua nga Tunizia për në Arabinë Saudite në janar, kur edhe filluan protestat mbarëpopullore në vend. Presidenti i ka mohuar të gjitha akuzat. ■

FUND LUFTËS, SHBA TËRHIQET NGA AFGANISTANI

Presidenti Barak Obama i tha popullit amerikan, se ka vendosur të tërheqë 33.000 trupa nga Afganistani. Obama u takua me ushtarët e Divizionit të 10-të Malor, një prej njësive të dislokuara më shpesh në Afganistan. Presidenti tha në një intervistë për “Zërin e Amerikës” të transmetuar në mbarë botën, se ai dhe këshilltarët e tij më të lartë mendojnë se pika kulmore e luftës po kalon dhe premtoi se Shtetet e Bashkuara nuk po e braktisin qeverinë e Kabulit me tërheqjen e trupave. Në intervistën për “Zërin e Amerikës”, Obama tha se forcat amerikane do të kenë një prani të gjerë në Afganistan edhe pas tërheqjes së trupave fillestare. Presidenti dha arsytet përse Shtetet e Bashkuara mund të fillojnë tërheqjen e trupave nga Afganistani. Ai tha se situata atje po përmirësohet dhe se tërheqja do të fillojë muajin e ardhshëm. “Ne duam të tërheqim 10 mijë trupa deri në fund të këtij viti dhe 23 mijë të tjerë deri në fund të verës së vitit të ardhshëm”. ■

FYEN AISHEN POR KËSHTU NDËSHKOHET

Ekstremisti shiit, Jasir el-Habibi, që tashme ka ikur në Londër, kishte shkaktuar reagime dhe polemika të shumta pas akuzave për nder dhe moral, fyerje dhe ofendime që i kishte bërë nënës së besimtarëve, zonjës Aishe, gruas së Resulullahut, Muhammedit, alejhi salatu ue selam. Diku nga fundi i vitit të kaluar ky shiit ekstremist kishte pasur një ballafaqim të drejtpërdrejtë televiziv me Muhamed el-Kusin, Imam dhe Ligjërues në Xhaminë el-Imam Malik, e që për shkak të arrogancës dhe shkeljeve shumë të rënda të parimeve bazë fetare, kishte bërë këtë të fundit të bindej se prej Zotit do ta kishte një dënim të shpejtë ngase kishte shpifur ndaj Allahut duke thënë se Ebu Bekri, Omeri, Aisheja dhe Hafsa ja janë në ferr. El-Habibi jeton në Angli që prej vitit 2004, atëherë edhe kur i ishte marre nënshtetësia kuvajtiane, për shkak se ndaj tij ishin lëshuar urdhëresat për burgim 10 vjeçar me akuzën e ofendimit të dy prej sahabive më të mëdhenj, Ebu Bekrit dhe Omerit, Allahu qoftë i kënaqur me ata dy. Ramazanin e kaluar, el-Habibi kishte organizuar një “party” me rastin e përvjetorit të vdekjes së nënës së besimtareve, Aishes, me ç’rast e kishte rënduar aq shumë, saqë e kishte quajtur edhe “armike e Allahut dhe armike e te Dërguarit te Tij!” Mirëpo, tani qëndron i shtrirë në spital nga kanceri që ka kapur gjuhën e tij. ■

PAS LUTJES SË TË PREMTES, NË SIRI KANË RINISUR PROTESTAT KUNDËR PRESIDENTIT BASHAR AL ASAD.

Sipas aktivistëve dhe dëshmitarëve, forcat e sigurisë përdorën gazin lotsjellës dhe qëlluan me armë në kryeqytetin e Sirisë, Damask dhe zona të tjera të vendit. Raportime, të pakonfirmuara flasin për 10 të vdekur. Siç ka ndodhur dhe në javët e shkuara aktivistët përmes rrjeteve sociale, bënë thirrje për t’ju bashkuar protestës me slogenin “Bashari nuk është më presidenti im dhe qeveria e tij, nuk më përfaqëson më mua”.

Organizata Arabe e të Drejtave të Njeriut në Siri i tha BBC-së, se pesë persona u vranë dhe të tjerë u plagosën, pasi forcat e sigurisë qëlluan me plumba të vërtetë kundër protestuesve, që po dilnin nga një xhami në Kisuah, që ndodhet në jug të Damaskut.

Snajperët qëlluan për vdekje të paktën tre persona në kryeqendrën e Barzehut. Dy protestues u vranë nga forcat e sigurisë në Hums. Komitetet e Koordinimit Lokal që monitorojnë protestat në Siri raportuan më herët për hyrjen e tankeve në periferi të Damaskut dhe bllokimin e rrugëve për në qendër të Humsit. Mijëra njerëz protestuan në Irbin, në Hums dhe Hama, në qendër të Sirisë, në Dera në jug të vendit dhe Kamishli dhe Deir Al Zur, në lindje. ■



ALTERNATIVAT ISLAME

Biseda për alternativa të këtilla aktualizohet në këtë kohë, kur Islami si model i organizimit të shoqërisë është larguar nga skena bashkëkohore dhe kur si pasojë e dekadencës, ai gjen aplikim të pakët edhe në jetën individuale.

SHKRUAN: MR. TALHA KURTISHI

Islami, si botëkuptim i përkryer, nuk ka alternativë tjetër, në asnjë aspekt të jetës individuale dhe shoqërore. Ky

është besimi i gjithë atyre që dëshmojnë, se Allahu është Zoti i tyre dhe se Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, është i Dërguari i fundit. Islami si fe dhe sistem i jetës është modeli më i përshtatshëm për botën, i aplikueshëm në çdo kohë dhe vend, sistem që në asnjë

mënyrë nuk ndeshet me arsyen e shëndoshë. Me një fjalë biseda për alternativat Islame nga këndvështrimi Islam është debat i panevojshëm, ngase vetë aplikimi i parimeve Islame, të përgjithshme dhe të detajuara, e anulon nevojën e një bisede të tillë.

Biseda për alternativa të këtilla aktualizohet në këtë kohë, kur Islami si model i organizimit të shoqërisë është larguar nga skena bashkëkohore dhe kur si pasojë e dekadencës, ai gjen aplikim të pakët edhe në jetën individuale.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë këto modele alternative të aspekteve të ndryshëm të jetës janë parakusht që ato të quhen Islame. Nga mesi i këtyre kriterëve do të veçoja:

Aplikimi i Islamit, në jetën individuale dhe atë shoqërore është imperativ i atij, që është i vetëdijshëm për rolin e mëkëmbësit në Tokë. Nga kjo pikënisje detyra e muslimanëve është të gjejnë mekanizma se si porositë hyjnore për mirëqenien e llojit njerëzor të arrijnë te njerëzit. Në këtë kaos në të cilin e mira vlerësohet si e keqe dhe anasjelltas duhet të angazhohemi që parimet e gjykimit të saktë të rikthehen në skenë. Alternativat islame, që në realitet, duhet/do të zëvendësojnë gjithë modelet e mangëta të organizimit shoqëror, janë pjesë e vazhdimësisë në kumtimin e porosisë: **“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira...”** (Isra, 9).

Kriteri i dytë që duhet të kihet parasysh është fakti se një alternativë nuk mund të jetë e tillë nëse nuk është në pajtim me parimet Islame. Çdo cenim i parimeve Islame gjatë definimit dhe përpilimit të alternativave Islame është mohim i

“Biseda për alternativat Islame nuk i lejohet atij që nuk ka njohuri të thella Islame...”

emërtimit të saj me mbiemrin Islame. Prandaj biseda për alternativat Islame nuk i lejohet atij që nuk ka njohuri të thella Islame, njohuri kjo e cila bashkon në një përmbledhje të kompletuar synimet madhore dhe detajet më të imta.

Gjatë përpilimit të alternativave drejtuesit e lëvizjeve të rizgjimit Islam duhet të përshijnë shtyllat e zhvillimit shoqëror. Në aktivitetin për riaktualizimin e vlerave Islame duhet fillimisht të përfshihet arsimit si faktori i dytë me fuqi për edukimin dhe orientimin e të rinjve. Duhet të këmbëngulet në arsim të mirëfilltë, të çliruar nga ndikimi i ideologjive devijuese, të promovohet shkenca, e cila assesi nuk ndeshet me parimet Islame, të merret guximi për t'u ballafaquar me sfidën e reformimit të arsimit si bazë e fuqisë. Shtylla e dytë e zhvillimit shoqëror është ekonomia, së cilës duhet t'i ofrohen modele alternative për t'u çliruar nga prangat e neokapitalizmit, i cili për shkak të sistemit të interesit (kamatës) dhe vlerës imagjinare (joreale) vazhdimisht do të gjenerojë krizë. Ekonomia gjithashtu duhet të mbështetet në resurset që posedohen, duke marrë parasysh parimet e prodhimit që nuk dëmton/rrezikon mjedisin jetësor. Parimet etike të Islamit sigurojnë pastrim dhe mbrojtje të administratës shtetërore nga korrupsioni,

e cila gjithashtu duhet të përfshihet me angazhimin për promovimin e alternativave Islame.

Muslimanët duhet të krijojnë/mbështesin një qendër, e cila do t'i përfaqësojë muslimanët dhe do të ketë fuqi për inicimin dhe realizimin e kërkesave të muslimanëve. Në situatën tonë kjo nënkupton mbështetjen e Bashkësive Islame dhe institucioneve të tyre si përfaqësues legjitimë të muslimanëve. Një përfaqësues i fuqishëm që bashkon dhe punon për të mirën e muslimanëve do të ndihmonte shumë në promovimin e alternativave islame. Për disa alternativa që kanë të bëjnë me disa detaje të jetës shoqërore dhe individuale, nuk ka pengesa që ato të realizohen me anën e organizatave jo-qeveritare. Mbështetja në partitë politike duhet të minimizohet duke formuar një bllok të fortë të lëvizjeve jo-politike, por që kanë ndikim në rrjedhat shoqërore.

Mediumet sot janë arma më e fortë e globalizimit, i cili sulmon identitetet e ndryshme duke krijuar një identitet të unifikuar. Angazhimi mediatik duhet të jetë në mesin e prioriteteve të veprimtarisë së muslimanëve. Sipas studimeve të fundit njerëzit kalojnë mesatarisht 8 orë para monitorëve të ndryshëm (të televizionit, të internetit, celularit). Alternativat Islame në fushën e medieeve kërkojnë angazhim dhe profesionalizim të shkallës së lartë. Ekzistimi i tyre do të zvogëlonte efektet destruktive të medieeve, që promovojnë gjithçka përveç vlerave Islame. Me këtë angazhim duhet të përfshihen të gjitha fushat e në veçanti televizioni dhe

interneti. Këto alternativa duhet t'i përfshijnë edhe gjitha kategoritë e njerëzve, që i ndjekin mediumet, fëmijët, adoleshentët, të moshuarit, gjininë mashkullore dhe atë femërore etj. Kjo nënkupton njohje të mirë të specifikave të këtyre kategorive, si dhe versione të përshtatshme të medimeve për ato kategori.

Në këtë angazhim alternativ muslimanët nuk duhet t'i anashkalojnë edhe mënyrat klasike të veprimtarisë Islame. Nuk duhet të anashkalojnë ligjëratat dhe hytbet në xhami, duhet të ndihmohen mejtepet dhe mualimët e Kuranit, duhet të ndihmohen medresetë dhe fakultetet e shkencave Islame. Në aspektin shoqëror duhet të ndihmohet zhvillimi i institucioneve të zekatit dhe sadakave, të ripërtërihet roli i vakëfeve, të ndihmohet ndërtimi i xhamive dhe publikimi i literaturës fetare. Xhamia duhet të bëhet boshti i shoqërive lokale, vendtubimi në të cilin muslimanët bashkohen dhe bashkëveprojnë për të mirën e muslimanëve në veçanti dhe njerëzimit në përgjithësi.

Allahut i takon falënderimi në fillim dhe në mbarim. ■



FUQIZIMI I VETËDIJES SË MBIKËQYRJES HYJNORE

fuqizimi i vetëdijes së mbikëqyrjes hyjnore në shpirtin e muslimanit është i domosdoshëm dhe çdo neglizhencë e jona rreth saj është humbje dhe shkatërrim.

MUHAMED IBËN SALIH EL UTHEJMIN

Vetëdijesimi për mbikëqyrjen hyjnore është dy llojesh: **Lloji i parë:** Mbikëqyrja jote kundrejt Allahut, *azze ue xhel*.

Lloji i dytë: Mbikëqyrja e Allahut kundrejt robit të Tij, siç e cek edhe Allahu, *azze ue xhel*, në Kuran: **“Allahu është mbikëqyrës për çdo gjë.”** Ahzab 52.

Sa i përket llojit të parë qëllimi i tij është që ti ta kuptosh, se Allahu e di çdo

send që po thua, po vepron apo beson. Allahu, *azze ue xhel*, thotë: ***“Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshirëplotin, i Cili e sheh qëndrimin tënd në këmbë (gjatë namazit) dhe lëvizjet e tua midis atyre që përulen në sexhde.”*** Shuara 217-219. Ajeti na bën me dije se ti, kur ngrihesh natën i vetmuar në një vend të errët, ku nuk të sheh askush, fillon ta falësh namazin dhe të përulesh në sexhde, dije se Allahu të gjitha lëvizjet e tua i përcjell dhe i mbikëqyr.

Po ashtu prej mbikëqyrjes tënde kundrejt Allahut është ta dish, se Allahu të dëgjon. Çdo fjalë që flet, qoftë e mirë apo e keqe dije se Allahu e dëgjon: ***“Vallë, a mos kujtojnë ata se Ne nuk i dëgjojmë fjalët e tyre tinëzore dhe bisedat e tyre të fshehta? Pa dyshim, Ne dëgjojmë, ndërsa të dërguarit Tanë (engjëj) që janë pranë tyre, shënojnë.”*** Zuhruf 80.

Mëso prej këtij ajeti se të gjitha thëniet e tua qofshin të mira apo të këqija, të fshehta apo të zbuluara, do të jenë dëshmi për ty, ose kundër teje: ***“Dhe për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”*** Kaf 18.

Merre këtë çështje me seriozitet dhe i mjeri ti, nëse flet fjalë jo-të hijshme, sepse për to do të japësh llogari Ditën e Kiametit. Mësoje gjuhën tënde të thotë fjalë të mira dhe të vërteta, ose të heshtë, ashtu siç na mësoi Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në një hadith të vërtetë: ***“Kush i beson Allahut dhe ditës së Fundit le të flasë mirë ose le të heshtë.”***

Po ashtu mos harro ta mbikëqyrësh Allahun në zemrën tënde. Shiko në zemrën tënde, se a gjendet ndonjë lloj i shirkut apo i hipokrizisë, apo devijim, apo armiqësi dhe urrejtje ndaj besimtarëve dhe dashuri ndaj jobesimtarëve, apo gjëra të ngjashme, të cilat nuk e kënaqin Allahun, *azze ue xhel*?

“Muslimanit nuk i mbetet asgjë tjetër vetëm se të jetë i vetëdijshëm, që Allahu e mbikëqyr dhe se ai duhet t'i frikësohet në vetmi, ashtu si i frikësohet në publik..”

Mbikëqyre Allahun në veprat e tua, në thëniet e tua dhe në zemrën tënde, deri sa të plotësohet mbikëqyrja jote. Për këtë shkak kur u pyet Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, mbi mirësinë (ihsanin), u përgjigj: ***“Ta adhurosh Allahun sikur ta shohësh, edhe pse ti nuk e sheh, Ai vërtet të sheh ty.”*** Adhuroje Allahun sikur ta shohësh para teje, dhe në rast se nuk e arrin atë gradë atëherë zbrit në shkallën e dytë: ***“Ai vërtet të sheh ty.”*** E para është adhurim dëshire, ta adhurosh Allahun sikurse ta shohësh, ndërsa e dyta është adhurim frike: ***“sepse edhe pse ti nuk e sheh, Ai vërtet të sheh ty.”***

Allahu, *azze ue xhel*, është kudo me robërit e Tij: ***“Ai është me ju kudo që të gjendeni.”*** Hadid 4. Në tokë, në det, në ajër, në errësirë, në dritë, dhe në çdo gjendje. Kjo aludon në përsosmërinë e përfshirjes së Allahut kundrejt nesh me dituri, me fuqi, me pozitë, me drejtim etj. Mirëpo kjo nuk duhet nënkuptuar, se Allahu është me ne në të njëjtin vend në tokë, sepse Ai është mbi të gjitha këto. Vendqëndrimi i Qenies së Tij është mbi shtatë qiejt mbi Arsh, ndërsa në tokë është prezent me dijen e Tij: ***“I Gjithëmëshirshmi mbi Fron u ngrit (si i takon Madhërisë së Tij).”***Taha 5, ***“Ai është i Sunduesi mbi robërit e Vet; Ai është i Urti dhe ka dijeni për gjithçka.”*** Enam 18,

“Ai është i Larti, Madhështori” Bekare 255, **“Lavdëro emrin e Zotit tënd, më të Lartit.”** Eala 1, **“A jeni të sigurt se kush është në qiell...”** Mulk 16.

Atij po ashtu nuk i fshihet asgjë në tokë dhe në qiell: **“Pa dyshim, Allahut nuk i fshihet asgjë në Tokë dhe as në qiell!”** Ali Imran 5. Këtë e sqaron në një ajet tjetër ku thotë: **“Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato. Ai e di ç’ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh).”** Enam 59.

Prej këtyre fjalëve që cekëm na bëhet me dije, se fuqizimi i vetëdijes së mbikëqyrjes hyjnore në shpirtin e muslimanit është i domosdoshëm dhe çdo neglizhencë e jona rreth saj është humbje dhe shkatërrim.

Le t’i kthehemi historive së popujve të mëhershëm, të cilat na i rrëfen Kurani dhe Suneti. Allahu, *azze ue xhel*, na njoftoi për popullin e Adit, Themudit, Faraonit dhe shumë popujve të tjerë, të cilëve i kishte dhuruar shumë të mira, duke filluar prej fizikut të tyre, vendbanimeve, bagëtieve etj. Mirëpo krahas të gjitha këtyre begative që kishin, ata të gjitha i mohuan, duke i bërë së pari shirk Allahut e pastaj duke i luftuar edhe të dërguarit e Tij. Harruan se Allahu i mbikëqyr veprat e tyre, e ata u bënë kryelartë në tokë. E merituan dënimin e Allahut, ashtu siç e meriton çdo zullumqar dhe prej gjurmëve të tyre nuk mbeti asgjë.

Allahu, *azze ue xhel*, thotë: **“Vallë, a nuk e di ti, se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad, banorë të Iremit me pallate shumëshpyllëshe, të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?! Dhe me fisin Themud, që gdhendi shkëmbinjtë në luginë (për të bërë shtëpi)? Dhe me**

Faraonin, njeriun e hunjve (ku torturonte njerëzit)? **Të gjithë këta shkelën çdo kufi në vendet e tyre, duke shtuar atje shthurjen dhe korrupsionin, prandaj Zoti yt lëshoi mbi ata kamxhikun e dënimit.”** Fexhër 7-13, dhe në fund e përfundon ajetin duke thënë: **“Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!”** Fexhër 14.

Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, po ashtu na njoftoi me disa ngjarje, të cilat e trajtojnë këtë temë dhe na bëri me dije, se sa e rëndësishme është fuqizimi i kësaj vetëdije në shpirtin e muslimanit. Prej këtyre ngjarjeve mund ta veçojmë hadithin, të cilin na e përcjell Ebu Hurejra, *radijallahu anhu*, prej Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili thotë: **“Tre njerëz nga Beni Israilët, Allahu azze ue xhel, dëshiroi t’i sprovojë. Njëri prej tyre ishte zgjeban, i dyti qelan, kurse i treti i verbër. Allahu ua dërgoi një melek, i cili së pari i vjen zgjebanit dhe i thotë: “Çdo të dëshiroje më së shumti?” Tha: “Më së shumti do të dëshiroja të kem ngjyrë dhe lëkurë të mirë dhe të çlirohem nga kjo për shkak të së cilës më urrejnë njerëzit.” Meleku e fërkoj me dorë dhe prej tij ranë krejt zgjebet dhe e fitoi ngjyrën e mirë (të trupit). (Pastaj meleku) Tha: “Cilën pasuri dëshiron më së shumti?” Tha: “Devetë - ose lopët” (nuk i kujtohet saktë transmetuesit), ai ia jep një deve me barrë dhe i thotë: “Allahu të bekoftë me të!” Pastaj shkoi te qelani dhe i tha: “Çdo të dëshiroje më së shumti?” (Qelani) Tha: “Flokë të bukura dhe të largohet prej meje ajo prej së cilës njerëzit neveriten nga unë.” Meleku e fërkon dhe ai shërohet e i jepën flokë të bukur. (Meleku) Tha: “Cilën pasuri dëshiron më së shumti?” (Qelani) Tha: “Lopët.” Meleku ia jep një lopë me barrë dhe i thotë: “Allahu të bekoftë me te.” Meleku i shkon të verbërit e i thotë: “Çdo të dëshiroje më së shumti?” (I verbëri) Tha:**

“Të ma kthejë Allahu shikimin, që t’i shoh njerëzit.” Meleku e fërkon dhe Allahu ia kthen shikimin. (Meleku) Tha: “Cilën pasuri e dëshiron më së shumti?” (I verbri) Tha: “Dhentë!” Meleku ia jep një dele që lind. Te të tre pasuria u shtua e u rrit, kështu që njëri (zgjebani) bëri një luginë me deve, i dyti (qelani) e bëri një luginë me lopë dhe i treti (i verbri) bëri një luginë me dele. Pas kësaj meleku i vjen zgjebanit në formë dhe pamje tjetër nga e mëparshmeja e i thotë: “Unë jam një njeri i mjerë, më janë këputur mundësitë në udhëtimin tim, prandaj sot askush nuk mund të më ndihmojë përveç Allahut, pastaj ti, kështu po të lutem në emrin e Atij që të ka dhënë ngjyrë dhe lëkurë aq të bukur dhe që të ka dhënë kaq deve, të më japësh një deve që të mund ta vazhdoj rrugën.” (Ish zgjebani, tani pasanik) Tha: “Jo, unë kam shumë detyrime.” (Meleku) I tha: “Sikur po të njoh unë ty, a mos ke qenë një zgjeban nga i cili neveriteshin njerëzit, një i varfër, të cilin Allahu e ka pasuruar?” Tha: “Unë këtë pasuri e kam trashëguar nga të parët e mëdhenj.” Meleku i tha: “Nëse po gënjen, le të të kthejë Allahu në atë gjendje në të cilën ke qenë!”

Meleku pastaj i shkon qelanit, por në formë tjetër, e i thotë ashtu siç i tha zgjebanit, por edhe ky i përgjigjet ashtu siç iu përgjigj zgjebani. Meleku i tha: “Nëse po gënjen, le të të kthejë Allahu në atë gjendje në të cilën ke qenë!”

Pastaj meleku i shkon ish-të verbrit, por në formë tjetër, dhe i thotë: “Unë jam i mjerë dhe udhëtar, më janë këputur mundësitë në udhëtimin tim, prandaj sot askush nuk mund të më ndihmojë përveç Allahut, pastaj ti. Të lutem në emrin e Atij që të ka kthyer të parët, më jep një dele, që të ndihmohem me te dhe të vazhdoj

rrugën.” (Ish i verbri) Tha: “Vërtet unë kam qenë i verbër, por Allahu më ka kthyer shikimin. Merr vëlla çka të duash dhe lër çka të duash! Pasha Allahun, asgjë sot nuk të ndaloj të marrësh në emër të Allahut të Gjithëfuqishëm e të Madhërishëm. Meleku i tha: “Mbaje krejt pasurinë, ju vetëm keni qenë të sprovuar. Allahu është i kënaqur me ty, kurse është i zemëruar me dy shokët e tu.” (Buhariu dhe Muslimi).

Muslimanit nuk i mbetet asgjë tjetër vetëm se të jetë i vetëdijshëm, që Allahu e mbikëqyr dhe se ai duhet t’i frikësohet në vetmi, ashtu si i frikësohet në publik, bile ai i cili i frikësohet Allahut në vetmi më shumë se haptazi, ai është i begatuar, për shkak se frika në vetmi është më e sinqertë krahas asaj, e cila shfaqet në publik dhe prej së cilës mund të sprovohesh me hipokrizi.

Prandaj ti, o vëlla musliman, kujdesu që t’i zbatosh urdhëresat dhe të largohesh prej ndalesave dhe e lus Allahun që të na mundësojë këtë, se në rast se nuk na ndihmon atëherë do të jemi të braktisur prej mëshirës së Tij, siç thotë Allahu, azze ue xhel: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”** Fatiha 5.

Kur begatohet robi me udhëzim dhe ndihmë sipas kornizave të shariatit, atëherë ky është ai njeri, të cilin Allahu e ka begatuar me të mirat e Tij. ■

Nga arabishtja: IRFAN JAHIU

HALLI I MEDIES ISLAME

Me termin “medie islame” nënkuptojmë ato medie që kanë synim përhapjen e virtyteve islame duke mos shkelur dispozitat e qarta fetare, pasi në fenë tonë qëllimi nuk i arsyeton mjetet

SHKRUAN: OMER BERISHA

Errallë është ajo shtëpi që nuk posedon ndonjë televizor së paku apo një kompjuter të kyçur me internet. Televizionet e shumta, tashmë edhe të

profilizuara në gjuhën shqipe pareshtur sjellin pamje që ngacmojnë syrin, turbullojnë trurin, dëmtojnë zemrën dhe dobësojnë imantin, nuk janë të rralla fyerjet ndaj vlerave të Fesë, përgënjeshttrimet e fjalëve të Allahut, ofendimet ndaj



besimtarëve e në kohë të fundit prej aty po nisen edhe fushatat e drejtpërdrejta kundër rizgjimit të popullit tonë për të ecur drejt Allahut, rizgim i cili është mirësi për të gjithë madje edhe për ata, mirëpo **“pak prej tyre logjikojnë”**. Është e vërtetë se ndonjëherë rezervojnë hapësirë kohore për ndonjë “natë të madhe” apo për festën e Bajramit, mirëpo edhe atëherë tregojnë kujdes të gjejnë hoxhallarë të atij kalibri, që do t'i drejtohen publikut duke folur për hallva, tradita dhe gjëra aq të përgjithshme, ku asnjëra nuk të le përshtypje dhe as nuk sinjalizon vizionin e Islamit, e që është: largimi i njerëzve nga robëria e njerëzve drejt robërisë ndaj Allahut.

Këtë hall ne nuk mund ta zhbëjmë, por gjithsesi kemi mundësi të ofrojmë mundësi të reja në medie, por fillimisht duhet ta kuptojmë se kemi problem, madje një problem të madh. Vetëdijesimi i besimtarëve me ndihmën e Allahut do të sjellë organizimin e fortë, harresën apo zbutjen e mospajtimeve që kanë ndodhur jo për hir të Allahut dhe rezultatin e synuar për të parë medie islame të atilla çfarë do t'ia kishin zili oponentët e tyre, për të memorizuar në televizorin tonë vetëm ato kanale që na shtojnë imanin, për të blerë vetëm ato gazeta e revista që na mësojnë synimet e larta, për të shfletuar në internet vetëm ato faqe të hairit dhe për të dëgjuar vetëm ato radio që na qetësojnë zemrat.

Me termin “medie islame” nënkuptojmë ato medie që kanë synim përhapjen e virtyteve islame duke mos shkelur dispozitat e qarta fetare, pasi në fenë tonë qëllimi nuk i arsyeton mjetet. Prej medieve në popullin tonë që kanë bërë hapat e parë në këtë rrugë do t'i kisha veçuar dhe jo përkufizuar është revista që keni në dorë dhe ueb-faqja me të njëjtin emër, Peace tv në gjuhën shqipe, radio pendimi që dëgjohet nëpërmjet internetit, si dhe

“Profeti, sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Bëni xhihad kundër politeistëve me pasuri, me trup dhe me gjuhë...” ”

iniciativa e re “Islami feja e vërtetë”, që njihet me aktivitetin e dalluar në YouTube dhe Facebook. Këto medie – me aq sa kam vërejtur – po mundohen të mbushin atë zbrazëtinë e sipërpërmendur, t'i dalin krah muslimanit për t'i dhënë mësimin e nevojshëm në kohën e duhur, t'i ofrojnë rrugëdaljet e shëndosha nga qorrsokakët e hera-hershme, t'i shpjegojnë çështjet e reja me metodologjinë e rrënjëzuar të Ehli Sunetit, me qëllim që të jenë në pajtim me mësimet e Kuranit dhe udhëzimet e Profetit, *alejhi salatu ue selam*. Ato gëzojnë pozitë përgëzuese në mesin e popullit pasi një pjesë e tyre janë bërë pikë-referimi për shqiptarët, që duan të kuptojnë mësimet islame lidhur me besimin dhe moralin, si dhe të njihen me qëndrimet që duhet pasur një musliman ndaj situatave të ndryshme që e rrethojnë. Këto medie duhet të kishin ofruar më shumë mundësi edhe për jomuslimanët e këtyre vendeve, por me sa duket angazhimi me nevojat e shumta të vetë muslimanëve, preokupimi me shërimin e injorancës së përhapur ndër vetë muslimanët ka bërë që kjo anë e veprimtarisë të jetë më e zbehtë.

Megjithatë lexuesit, shikuesit, surfuesit apo dëgjuesit e këtyre medieve nuk arrijnë përveçse një përqindje të vogël në krahasim me mediet e sherrit. Jo pse bartësit e këtyre projekteve të bekuara nuk dinë apo nuk kanë kuadër për të ofruar gjëra më të mira se sa ofrojnë të tjerët, mirëpo vonimi i muslimanëve botërisht në

këtë drejtim dhe pengesa materiale ndoshta janë vendimtare për të pasur këta hapa të ngadalshëm të suksesit. Shpesh muslimani akuzohet për financime nga jashtë, nga qarqe “të dyshimta”, madje edhe qarqe terroriste sa herë kur shihet se muslimanët bëjnë ndonjë organizim apo realizojnë ndonjë projekt. Ata e bëjnë, me qëllim që të pengojnë e frikësojnë edhe ata pak kontribuues dashamirë nga sadakaja, reklama dhe ndihmat e tjera, meqë ashtu do të bien në sy të keq para shtetit, para klientëve apo me fjalë të tjera edhe ata do bëheshkan pjesëmarrës në “krim”. Normalisht ata duan që ta shohin muslimanin të zbrapsur, të paarsimuar, të leckosur, lypës dhe të përçmuar, që pastaj të shprehin “rahmetin” e tyre, që duhet paguar me braktisjen e fesë, qoftë edhe pjesërisht. Fatkeqësisht ndonjëherë ia arrijnë qëllimit, por ne nuk duhet të harrojmë, se **“Ata duan të shuajnë dritën e Allahut, por Allahu do ta plotësojë këtë dritë, megjithëse qafirët e urrejnë”**.


Detyra e të gjithë neve është të japim kontributin tonë për të pasur medie qëllimira, që do ta ndihmojnë publikun në rregullimin e raporteve të tij me Krijuesin, me njerëzit, por gjithsesi edhe me vetveten. Nuk guxojmë të biem pre’ e fushatave të sipërpërmendura, apo të kemi komplekse për Fenë e shpëtimit. Le ta shfaqim atë që urdhërohemi, ndërsa zhurmuesve s’kemi pse t’u kushtojmë vëmendje në shkallë të madhe. Secili duhet të tregojë përkrahjen e tij për të themeluar medie islame, për t’i ndihmuar ato me ide e plane, e gjithsesi edhe me të holla, sepse ato nuk kanë hise në reklamën shtetërore, ndonëse japin një kontribut të madh në përmirësimin e shoqërisë, as në reklamën e ndërmarrjeve gjigante në mënyrë që të siguronin një buxhet të mjaftueshëm për vazhdimin e punëve. Këtu më duhet të

“Pastërtia e veprave të hairit nuk duron ndyrësinë e interesave të ngushta të kësaj bote...”

përmend edhe një sqarim rreth dhënies së zeqatit. Allahu ka thënë: **“Vërtetë zeqati u takon të varfërve, të ngratëve, atyre që e tubojnë, atyre që duhet zbutur zemrat, atyre që janë në robëri, atyre që kanë borxhe, në rrugë të Allahut dhe atyre që kanë mbetur në udhë. Detyrim nga Allahu. Allahu është i Dijshëm dhe i Urtë”**. Për grupin **“në rrugë të Allahut”** shumica e dijetarëve thonë se është për qëllim xhihadi. Shumë dijetarë kanë përmendur se është për qëllim xhihad fizik, pra me trup dhe me armë. Mirëpo xhihad nuk mund të cungohet vetëm në atë fizik sepse – siç thotë Ibën Tejmije – “xhihad mund të bëhet me dorë, por mund të bëhet edhe me argumente, sqarime dhe davet (thirrje). Allahu ka thënë: **“Sikur të donim Ne, do të dërgonim në çdo qytet paralajmërues. Mos i dëgjo qafirët, por bëji xhihad ata me forcë nëpërmjet Kuranit”** (Furkan 51-52). Pra, Allahu e urdhëroi të bëjë xhihad të fortë me Kuran. Kjo sure ka zbritur në Mekë, përpara se të emigronte Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem* dhe përpara se të urdhërohej lufta. Ky xhihad bëhej me dije, zemër dhe davet e jo me luftë”. (Minhaxhu Sunne Nebevijeh 8/86). Po ashtu Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: **“Bëni xhihad kundër politeistëve me pasuri, me trup dhe me gjuhë.”** (Sahih Ebu Davud nr. 2504). Të njëjtin mendim e ndajnë edhe disa dijetarë bashkëkohorë, vendim të njëjtë ka marrë edhe Asambleja e Fikhut Islamik, ndërsa dijetari i famshëm Muhamed ibën Ibrahim

Alu Shejh ka thënë: “...së këndejmi ka një çështje me rëndësi, ku lejohet të derdhet zeqati e që është përgatitja e forcës financiare për të thirrur në këtë fe dhe për të mposhtur dyshimet e përhapura. Këto janë xhihad, madje nga “*fi sebililah*”-u më i madh.” (4/142).

Para së gjithash, nuk duhet të harrojmë se kontributi në këto fusha duhet bërë me sinqeritet, me qëllim të arrihet kënaqësia e Allahut të Madhërishëm. Vazhdimisht t’ia japim këtë këshillë vetes dhe bashkëpunëtorëve. Sepse mungesa e sinqeritetit apo dëshira për të fituar famë a gjëra të tjera bëhen pengesat më të mëdha në punët e hairit dhe kjo është normale pasi pastërtia e veprave të hairit nuk duron ndyrësinë e interesave të ngushta të kësaj bote. Asisoj rezultojnë supozimet e këqija, keqkuptimet e ndoshta edhe armiqësitë e pabaza brenda muslimanëve, që do të manifestohen me ndarje nga një organizim, me mospjesëmarrje në aktivitete e ndoshta – Zot na ruaj – edhe me pengim të hairit, duke mos qenë i vetëdijshëm, e gjithë ajo me qëllim për të fituar lirinë e vetëvendosjes, siç ndodh me disa besimtarë të flaktë për punë ku secili në vete hapë nga një faqe në internet, që ai vetë të vendosi se çfarë, kur, kë dhe si të dojë. Kështu mund të gjesh me dhjetëra ueb-faqe islame në gjuhën shqipe, ku nuk mund të dallosh dobinë nga dëmi që shkaktojnë, për shkak të mospërgatitjes së përshtatshme, mosnjohjes së prioriteteve dhe preferencave personale. Kurse nëse do të ndërmerrim hapa për të bashkuar dhe menaxhuar denjësisht ato potenciale sigurisht do të jepnim një ofertë cilësore dhe të bekuar me lejen e Allahut. Suksesi është në dorë të Allahut. ■



HALID SHMIT - BERLIN

www.aljazeera.net

Kryeredaktori i gazetës gjermane Frankfurter Allgemeine Zeitung Wolfgang Günter Lerch tha se bota sot nuk do ta shilte me sy internetin e as kompjuterin sikur të mos ishin teoritë dhe konceptet e themeluesit të dy shkencave asaj të logaritmit dhe të algjebrës, si dhe autori i rregullave të shkencës së aritmetikës bashkëkohore, dijetari musliman Ebu Xhafer Muhamed ibën Musa El-Havarizmij. Lerch tha që pionierët gjerman të shkencës së matematikës Adam Reza dhe Carl Friedrich Gauss, Kurt Javidal ndërtuan kërkimet e tyre shkencore mbi rezultatet që kishte arritur El - Havarizmij, të cilit i atribuohet koncepti i Havarizmit - algoritmit në matematikë dhe numërohet të disa matematicientë si baba shpirtëror i shkencës së aritmetikës.

NUK DO TË KISHTE INTERNET PA EL-HAVARIZMIN

Ai shtoi: “nuk diskutohet në asnjë temë shkencore rreth rëndësisë së internetit pa u argumentuar me havarizmitë – algoritme të cilat i zbuloi astronomi dhe matematicienti i madh musliman, i cili vjen nga një vend i quajtur Havarizm tash gjendet në mes Uzbekistanit dhe Turkmenistanit“.

Lerch gazetari gjerman njohës i historisë dhe civilizimit islam përmendi gjithashtu që Havarizmi numërohet njëri nga shkencëtarët më të njohur në botën arabe dhe islame në lëmin e matematikës, astronomisë dhe aritmetikës. I njëjtë ishte edhe Ebu Rejhan El – Bejruni i cili vendosi themelet e para në shkencat e gjeografisë, të hartave si dhe shkenca të tjera. Gazetari gjerman paralajmëroi që përkthimet e veprave të El-Havarizmit në mesjetë në gjuhën latine i ndihmuan Evropës që të arrijë deri te ato që i përdorë sot si teori të reja në shkencat e matematikës dhe aritmetikës, duke aluduar në autorin e librit “algjebra dhe intervista” i cili është themeluesi i bazave të shkencave të algjebërës dhe llogaritjes së logaritmit, dhe i pari që e futi në funksion zeron në llogaritje, zbulues i shenjës së barazimit si dhe shumëzimit të mbledhjes dhe zbritjes.

Gjithashtu vuri në dukje që El – Havarizmi

u mbështet në ekuacionet e tij matematikore në numra dhe shenja matematikore kurse grekët mbështeteshin në shkronja dhe vizatime.

Shtëpia e Urtësisë

El – Havarizmi pjesën e dytë të jetës së tij e kaloi në Bagdad kryeqytetin e artë të Kalifatit islam të Abasidëve që në kohën e tij shtrihej nga Afrika veriore e gjerë tek Azia qendrore.

Ai gjithashtu vuri në dukje rolin e kalifëve abasid në mbështetjen e diturisë dhe inkurajimin e muslimanëve që të hapen ndaj kulturave dhe civilizimeve të ndryshme. Kalifi Memun e kishte caktuar El – Havarizmin në krye të “Shtëpisë së Urtësisë” në të cilën shkriheshin idetë dhe përvojat e dalluara të të gjithë dijetarëve si të atyre musliman e po ashtu edhe të tjerë.

Në fund kryeredaktori i gazetës Frankfurter Allgemeine Zeitung shtoi : “edhe pse viti i lindjes së El – Havarizmit mbeti i panjohur mirëpo ndikimi i këtij dijetari të madh do të mbetet i madh dhe tregues për të gjitha kohërat dhe vendet”. ■

*Përktheu dhe përshtati nga gjuha arabe
Sami T. Fetahi*

NUK KA ISLAM PA NJË XHEMAT



nëse një diktator vihet në krye të tij, kjo vjen jo për shkak të forcës së tij, por për shkak se vetë bashkësia, e cila e gjitha ose pjesërisht, ka rënë dakord, qoftë edhe me heshtje, për t'iu bindur atij

SHKRUAN: JUSTINIAN TOPULLI

Njeriu është krijuar nga Allahu për të qenë ndër të tjera edhe një qenie shoqërore, dhe si i tillë ai ndryshe nga

shumë krijesa të tjera i duhet të jetojë në një bashkësi njerëzore. Organizmi i bashkësisë njerëzore është një domosdoshmëri logjike, sociale dhe fetare. Jeta e një bashkësie ndër të tjera varet edhe nga organizimi i saj, organizim i cili

“... Individualizmi i skajshëm është i refuzuar në Islam, qoftë ky në formën e murgjërisë, qoftë edhe të lirisë së tepruar të mendimit dhe veprimit...”

dëshmia më e qartë e këtij obligimi madhor për të cilin Umer ibën Hatabi do të shprehej: **Nuk ka Islam pa një xhemat, dhe nuk ka xhemat pa një udhëheqësi, dhe nuk ka udhëheqësi pa bindje. Atë që populli i tij e vë në krye për fik'hun që ka, ai do të ketë jetë për vete dhe për të tjerët. Ndërsa atë që populli i tij e vë në krye duke mos qenë i tillë, ai do të jetë shkatërrim për vete dhe për ta.**¹

Kjo thënie në vetvete e parë nga një këndvështrim i përgjithshëm tregon domosdoshmërinë e jetës komunitare në mes myslimanëve. Adhurimi në Islam nuk kufizohet vetëm në veprimet individuale që njeriu kryen karshi Zotit, por ai del edhe përtej kësaj sfere. Kështu bamirësia ndaj tjetrit, me të gjitha format e saj, është adhurim, zbatimi i ligjit të Zotit në mes njerëzve është adhurim, dhe të dyja këto adhurime nuk mund të kryhen përveçse kur ekziston një bashkësi. Duke qenë se Islami është nënshtrim ndaj Zotit, pra adhurim i Tij, atëherë ky adhurim nuk mund të jetë i plotë nëse nuk ekziston një bashkësi ku ai të zbatohet, ose e thënë në terma fetar një xhemat njerëzish ku ai do

vetvetiu mbart me vete të drejta dhe detyrime reciproke, për të gjithë anëtarët e bashkësisë. Islami si një fe e përbotshme dhe përfundimtare e obligon krijimin e një bashkësie për pasuesit e tij, si mjetin kryesor për realizimin e adhurimit të Allahut mbi tokë. Historia islame është

¹ Transmeton Ed-darimi nr.251, Ibn Abdul Ber në Xhamiu Bejan el-ilmi ue fadlihi nr.298, me zinxhir të mirë transmetimi.

të marrë jetë. Pra Islami (adhurimi i Zotit), nuk mund të ekzistojë pa pasur një xhemat, një bashkësi njerëzish që bëjnë një jetë komunitare dhe jo individuale. Individualizmi i skajshëm është i refuzuar në Islam, qoftë ky në formën e murgjërës, qoftë edhe të lirisë së tepruar të mendimit dhe veprimit, për vetë faktin që ky individualizëm nuk është gjë tjetër vetëm se refuzim i bashkësisë dhe i jetës komunitare, që Islami e urdhëron. Nuk do të zgjateshim pa vend, nëse do të thonim se, individualizmi i tepruar bashkëkohorë perëndimor, nuk është gjë tjetër vetëm se zëvendësimi i murgjërës së djeshme për të adhuruar Zotin, me “murgjërinë” e sotme për të adhuruar epshet dhe materien. Islami nuk bën thirrje për një jetë tërësisht komunitare, ku humbet roli i individit dhe i individualizmit të tij, por ai vë një balancë natyrore ndërmjet këtyre dy ekstremeve. Nëse sistemi thellësisht komunitar, siç qe komunizmi, e përçmon dhe e denigron rolin e individit, individualizmi i skajshëm e bën njeriun pre të djallit dhe të devijimeve të tij, “*Kapu pas xhematit, sepse ujku në mes deleve ha të vetmuarën*”² thotë i Dërguari i Allahut.

Më tej në thënien e Umerit do të shohim sesi në mënyrë logjike përshkallëzohet arsyetimi që tregon se një bashkësi, çfarëdo qoftë ajo, nuk mund të mbahet në këmbë vetëm se nëpërmjet një udhëheqësie, pra nëpërmjet asaj që në gjuhën e sotme quhet institucion. Institucioni është ai që i jep jetë dhe vazhdimësi bashkësisë, për këtë dhe lloji

njerëzor ka ngritur shtetin, në dallim me kafshët apo edhe njerëzit e vetmuar, të cilët nuk e vrasin mendjen për ekzistencën e institucionit. Institucioni është ai që zbaton parimet dhe ligjet e Zotit dhe kujdeset për mbarëvajtjen e tyre, institucioni është përmbartuesi i ligjeve të Zotit në tokë,³ ndaj dhe për këtë ai është mjet i domosdoshëm për kryerjen e adhurimit të Tij.

Më pas Umeri tregon se institucioni nuk mund të funksionojë nëse atij nuk i bindemi, ai nuk mund të jetojë as edhe një ditë nëse nuk respektohet, për rrjedhojë pas gjithë kësaj mund të themi se ngritja e institucionit dhe respektimi i tij është adhurim ndaj Zotit, është vetë Islami. I Dërguari i Allahut thotë: “*Ai që më bindet mua i është bindur Allahut, dhe ai që nuk më bindet, nuk i është bindur Allahut, e ai që i bindet prijësit tim*”⁴, *më është bindur mua dhe ai që nuk i bindet prijësit tim, nuk më është bindur mua.*”⁵

Më pas Umeri kalon në mënyrën sesi duhet të funksionojë institucioni, në pikën më të rëndësishme të këtij mekanizmi të urdhëruar nga Zoti, në cilësitë e njeriut apo të udhëheqjes që duhet të bëhet lëvizësi i institucionit si dhe në mënyrën sesi kjo udhëheqje duhet të vendoset. Nga fjalët e Umerit nënkuptohet se përgjegjës për ardhjen e individëve të caktuar në krye të institucionit janë vetë njerëzit, vetë të bindurit, vetë bashkësia e njerëzve që e pranon atë. E parë në një këndvështrim tjetër do të thotë se institucioni nuk mund të uzurpohet nga

2 Transmeton Ebu Daudi nr.547 dhe Nesaiu nr. 2/106-107.

3 Ndaj dhe në Islam nuk lejohet për shembull vetëgjyqësia.

4 Prijësit të caktuar prej meje.

5 Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

individui, pra nëse një diktator vihet në krye të tij, kjo vjen jo për shkak të forcës së tij, por për shkak se vetë bashkësia, e cila e gjitha ose pjesërisht, ka rënë dakord, qoftë edhe me heshtje, për t'iu bindur atij. Umeri në këtë pjesë gjithashtu tregon se institucioni duhet të përbëhet nga njerëz që kanë fik'h dhe fik'hu është një dije aktive, një aftësi që ndër të tjera zbërthen dijen teorike dhe e zbret atë në mënyrën më të përshtatshme në truallin e realitetit, gjë që ndryshe përkthehet si sukses individual dhe kolektiv, duke qenë se bindja e bashkësisë ndaj ideve të suksesshme individuale sjellë për rrjedhojë edhe suksesin e institucionit, pra të bashkësisë.

Padyshim që mbarëvajtja e jetës tonë si muslimanë kërkon që ajo ndër të tjera të jetë e organizuar në nivelin më të lartë të saj, atë të institucionit të kalifatit, por mos ekzistenca e tij në situatën aktuale të ndarjeve territoriale dhe politike, nuk përbën asnjë justifikim për mos ngritjen e organizmave që do të zëvendësojnë deri diku rolin e tij, mosekzistenca e të cilave mund thuhet me plot gojën se rrezikon seriozisht vetë ekzistencën e Islamit në shumë vende të botës. Ndaj është absurde të mendosh se një bashkësi islame, kudo qoftë ajo, do të ketë një mbarëvajtje më të mirë nëse nuk do të ketë organizim, ku çdo gjë do t'i lihet spontanitetit dhe individualitetit! I dërguari i Allahut duke folur për domosdoshmërinë e një institucioni udhëheqës edhe në nivele më të ulëta, thotë: *“Nëse tre veta dalin për udhëtim, le të vënë një udhëheqës mes*

tyre.”⁶ Ibën Tejmije për rëndësinë e kësaj gjëje shprehet: “Duhet të dihet se udhëheqësia për njerëzit është një nga detyrimet më të mëdha të fesë. Madje nuk mund të ngrihet feja vetëm se nëpërmjet saj. Bijtë e Ademit nuk mund t'i plotësojnë nevojat e tyre vetëm se duke u bashkuar, për shkak të nevojës që kanë për njeri-tjetrin. Në bashkimin e tyre ata patjetër duhet të kenë një të parë, aq sa edhe Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *“Nëse tre veta dalin për udhëtim, le të vënë një udhëheqës mes tyre”*. Po kështu imam Ahmedi transmeton nga Abdullah ibën Amër se Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *“Nuk u lejohet tre njerëzve që gjinden në një tokë të shkretë, të mos e caktojnë mes tyre një prijës.”* Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* e bëri të detyrueshme që në një bashkësi të vogël dhe të përkohshme si udhëtimi, një njeri të vihej si udhëheqës, duke dashur që me këtë të tërheq vëmendjen për të gjitha llojet e bashkësive.”⁷

Ndaj del më se e qartë se myslimanët kudo që ndodhen duhet të kenë bashkësinë e tyre, institucion ky i cili, në pamundësi, zëvendëson deri diku kalifatin e munguar, e për rrjedhojë është e kuptueshme që, të drejtat dhe detyrimet e këtij institucioni ndaj besimtarëve detyrimisht do të kufizohen në hapësirën mundësive të tij. ■

■
6 Transmeton Ebu Daudi, Ahmedi.

7 Shih Es-sijase Esh-sherije, Mexhmua el-fetaua 28/390.

MBIJETESË

në tri faza

Të jesh musliman në shekullin njëzetë e njëjtë, në nënqiellin tonë nuk është gjë e lehtë. Të kesh punë me këta që kemi përreth, por edhe me vetveten është akoma më e vështirë

SHKRUAN: EKREM B. AVDIU

Të gjithë e dimë se mbijetesa në këtë botë kërkon një mjeshtri, aftësi dhe gjetje të madhe, porse të gjitha këto do të ishin jofunksionale sikur të mos ishin edhe udhëzimet praktike për t'u gjetur dhe udhëzuar. Ndërsa ekzistojnë faktorë anësorë, që nganjëherë janë në anën e njeriut, e shumë herë qëndrojnë përballë tij. Në kohën e 'gurbetit' mbijetesa e individit brenda një komuniteti është sfidë, por qëndrueshmëria e komunitetit në vorbullën e përballjeve, konflikteve,

mospajttimeve, konkurrencave etj., përbën një sukses që duhet dëshiruar e për të cilin duhet të përvjelim mëngët.

Të jesh musliman në shekullin njëzetë e njëjtë, në nënqiellin tonë nuk është gjë e lehtë. Të kesh punë me këta që kemi përreth, por edhe me vetveten është akoma më e vështirë. Por edhe kur i kemi parasysh të gjitha paralajmërimet, që për neve janë përgëzime më shumë se çdo gjë tjetër, atëherë e kuptojmë se mbijetesa jo vetëm që është e mundshme, por është një ofertë të cilën e kemi fare pranë dorës dhe vetëm duhet ta marrim. Për mendimin

tim, janë tri gjëra të cilave do të duhej t'i përmbahen muslimanët, në mënyrë që të kenë sukses në këtë drejtim.

E para: Duhet të harrojmë se individualisht mund të arrijmë çfarëdo suksesi. Individualizmi është i aplikueshëm vetëm në fazën e nisjes dhe është i tolerueshëm vetëm sa për t'iu bashkëngjitur karvanit. Të gjitha mësimet islame, madje edhe ato që duken se janë shumë të lidhura me botën tjetër na e mësojnë këtë. Por kjo porosi ka esencën e vet: Për të funksionuar një bashkësi (xhemat, komunitet) ashtu si duhet, patjetër duhet të dihet epiqendra. E veçanta e Islamit dhe mësimave të tij është se boshti rreth të cilit sillen muslimanët nuk është individi, por ideja, mësimi, argumenti. Këtë forcë e bëjnë të aplikueshme njohësit e mirëfilltë të saj, e ata janë dijetarët. Dija dhe dijetarët përbëjnë pra, autoritetin real për muslimanin dhe në momentin kur kjo kuptohet si duhet punët do të shkojnë në drejtimin e duhur. Rreziku ndodh atëherë kur krijohen autoritetet e rreme, apo kur kontestohen ato të vërtetat. Në kohët e

“...Është e papërgjegjshme dhe shumë e gabuar që ne të “rrihemi” ndërmjet vete me ajete dhe hadithe...”

hershme të Islamit, tentativa dhe iniciativa të këtilla vinin nga munafikët. Në kohët e sotme gjëra të këtilla, me apo pa dashje bëjnë edhe të atillë që në sytë tonë vlejné për njerëz të mirë. Nëse dikush është i mirë, kjo nuk e ndërron “cilësinë” e gabimit, ashtu sikur nuk ndikon as edhe “qëllimi i mirë” i pretenduar jo rrallë.

E dyta: Të gjitha ato citate, ajete e hadithe, që flasin për përgjegjësi, gabime e dështime janë për ne. Kur them për ne, kam si qëllim që çdonjëri prej nesh të marrë ajetet apo hadithet kërcënuese dhe të bëjë prej tyre një mekanizëm për përmirësimin vetjak, duke e konsideruar se çdo citat i kësaj natyre i dedikohet drejtpërdrejt atij, e jo dikujt tjetër. Për të rritur efikasitetin e këtyre citateve në jetën tonë ne duhet të përjashtojmë çdo

mundësi që ato t'i jenë drejtuar dikujt tjetër, e jo neve. Konsideroj se është e papërgjegjshme dhe shumë e gabuar që ne të "rrihemi" ndërmjet vete me ajete dhe hadithe.

E treta: Kur jemi vetëm duhet të konsiderojmë, se unë jam njeriu më i keq, se gjithë të tjerët janë më të mirë se unë. Të kultivojmë frikën në veten tonë, se ndoshta Mëshira e Allahut mund t'i përfshijë të gjithë, madje edhe ata që në sytë tonë vlejnë për mëkatarë të mëdhenj, përveç neve. Kjo ndjenjë e kultivuar në brendinë tonë do të na bëjë vetëkritikë, modestë dhe të kujdesshëm në sjelljet tona me të tjerët. Ndërsa publikisht, nuk kemi asnjë të drejtë, që t'i ofrojmë vetes komoditet në Mëshirën e Allahut, ndërsa të tjerët të tentojmë t'i privojmë prej saj. Nëse jo për diçka tjetër, atëherë për shkak se nuk e kemi këtë kompetencë. Kjo është ajo që unë e quaj mbijetesë në tri faza.



PENDIMI NGA PËRFITIMI I PASURISË NË MËNYRË TË PALIGJSHME (1)



Nëse dikush ka vjedhur hekur apo dru dhe këtë material e ka futur në ndërtim. Në këtë rast prona e këtyre përfitimeve të ndaluara i takon pronarit të saj dhe pronari është i lirë të përzgjedhë në mes marrjes dhe plotësimin e mangësisë,

DR. HALID BIN ABDULLAH EL-MUSLIH

Nga pesë objektivat madhore të Islamit (mekasid sherije) është edhe ruajtja e pasurisë. Duke u nisur nga ky parim muslimani duhet të ketë në konsideratë se si po e fiton pasurinë, për shkak se përfitimi i pasurisë haram është shkaktar për pengimin e shumë mirësive që nuk mund t'i arrijnë njeriut.

¹ Bekare, 172.

Muslimi ka shënuar hadithin e Ebu Hurejrës, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë: Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: “O ju njerëz! Me të vërtetë Allahu është i Bukur dhe pranon vetëm të bukurën. Me të vërtetë Allahu i ka urdhëruar besimtarët me atë që i ka urdhëruar Pejgamberët dhe ka Thënë:

“O ju që besuat, hani nga të mirat që ua kemi dhënë dhe falënderoni Allahun, nëse jeni që vetëm Atë e adhuronit.”....

Nga shenjat e kësaj kohe përfitimet e paligjshme është ajo që na ka paralajmëruar Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, se do të ndodhin. Shënon Buhariu hadithin e Seid Makberit nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se Pejgamberi *sal-lallahu alejhu ue selem* ka thënë: “Do të vijë një kohë kur njerëzit nuk do të shikojnë se nga e përfitojnë pasurinë nga hallalli apo harami.”

Realiteti i përfitimeve të paligjshme:

Përfitimi i paligjshëm është: “Pasuri e cila është arritur apo mbledhur nëpërmjet rrugëve jo të ligjshme në sheriati islam.”

Arritja tek përfitimet e ndaluara ndodh përmes shumë rrugëve, por ne do të cekim dy rrugë kryesore nëpërmjet të cilave arrihet pasuria e ndaluar.

Rruga e parë: Pasuria të jetë arritur pa pëlqim. Përfitimet të cilat janë mbledhur janë bartur nga pronari tek personi në fjalë pa pëlqimin e pronarit si: Vjedhja, uzurpimi, mashtrimet.

Rruga e dytë: Pasuria të jetë arritur me pëlqimin e dy palëve. Përfitimet të cilat i ka marrë janë bartur nga pronari tek personi në fjalë me pëlqim, si rezultat i kontratave të paligjshme, si: kamata, bixhozi, shitblerja e alkoolit, substancave narkotike apo përfitimet nga imoraliteti,

magjia, korrupsioni etj.

Tani do të sjellim sqarimin e dy rrugëve të lartpërmendura.

1. Përfitimet e paligjshme të arritura pa pëlqimin e palëve:

Pronësia e pasurisë në këto lloje të përfitimeve kujt i takon?

Në esencë këto përfitime mbesin në pronësi të pronarëve të tyre. Por kjo mund të ndryshojë në rast se (pasurisë së arritur pa pëlqimin e palëve) mund t'i ndodhë shtimi apo mangësimi. Ky ndryshim mund të jetë tre llojesh.

a) Përfitimet e ndaluara që kanë mbetur pa ndryshuar:

Nuk ka mospajtim mes dijetarëve se prona e këtyre përfitimeve të paligjshme i takon pronarëve të tyre dhe ai i cili ua ka marrë e ka për detyrë që t'ia kthejë këtë pasuri, nëse dihet pronari i tyre dhe nuk janë përjetuar shtim apo mangësim.

Ibën Ubejre thotë: “Dijetarët kanë rënë në pëlqim, se uzurpuesi është i detyruar ta kthejë pasurinë e uzurpuar nëse pasuria ekziston dhe nuk frikësohet se ky kthim mund të shkaktojë mbytjen e ndonjë personi.

b) Përfitimet e ndaluara që kanë mbetur, por janë dëmtuar:

Nëse këto përfitime të ndaluara janë shkatërruar në tërësi dhe nuk ka mundësi t'i kthehet pronarit të saj, dispozita e saj ndryshon në bazë të gjendjes. Në këtë rast nuk mund të dalë nga dy gjendje:

Gjendja e parë: Që këto përfitime të ndaluara të jenë të llojit të ngjashëm. Në këtë rast obligohet t'ia kthejë me po të njëjtin lloj të ngjashëm.

Gjendja e dytë: Që këto përfitime të ndaluara të jenë në sasi. Në këtë rast

“...Përfituesi e largon barrën në këtë botë dhe botën tjetër, nëse ua kthen qoftë edhe trashëgimtarëve të pronarit përfitimet e paligjshme...”

obligohet që përfituesi ta kthejë (pasurinë) sasinë. Në këtë rast katër imamët janë pajtuar.

c) Përfitimet e paligjshme që kanë ndryshuar:

Prona në këtë rast ndikohet varësisht nga lloji i ndryshimit. Këto ndryshime mund të jenë, ose në përgjithësi që kanë ndryshuar, ose pjesërisht në shtim, ose pakësim.

- Ndryshimi i përgjithshëm: Shembull: Nëse dikush ka vjedhur hekur apo dru dhe këtë material e ka futur në ndërtim. Në këtë rast prona e këtyre përfitimeve të ndaluara i takon pronarit të saj dhe pronari është i lirë të përzgjedhë në mes marrjes dhe plotësimin e mangësisë, ose në mes kërkimit me zëvendësim të atij ndryshimi që ka ndodhur pa marrë parasysh se ky ndryshim ka ndodhur me teprim apo mangësim, ose me diçka tjetër. Problemi qëndron se përfituesi nuk ka dorë të sigurt dhe ai në të gjitha gjendjet duhet të kompensojë.

- Ndryshimi me pakësim: Ky lloj ndryshimi nuk ndikon në pronën e pronarit të saj, kjo i takon atij dhe pjesa e pakësuar i kompensohet.

- Ndryshimet me shtim: Ky ndryshim nuk ndikon në heqjen e pronës nga dora e pronarit të saj.

Fitimet nga këto lloje përfitimesh të paligjshme

Dijetarët kanë rënë në mospajtim se fitimet e këtyre përfitimeve të paligjshme të arritura pa pëlqimin e palëve në pronën e kujt hyjnë.

Nga mendimet e tyre shihet se më i saktë është mendimi, se këto fitime që kanë ardhur nga puna e përfituesit ky është ortak me pronarin në këto fitime. Ky është një transmetim nga imam Ahmedi dhe këtë mendim e mbështet Ibën Tejmije dhe Ibën Kajimi dhe kjo është përzgjedhja me të cilën ka punuar kalifi Omer bin Hatab Allahu qoftë i kënaqur me të, dhe janë pajtuar shokët e Pejgamberit *sal-lallahu lejhi ue selem*. Në këtë ka drejtësi sepse shtimi apo fitimi ka ndodhur nga puna e këtij (uzurpuesit) dhe pasuria e pronarit nuk i takon vetëm pronarit në këtë rast që njëri të dallohet me fitim nga tjetri dhe nuk ka nevojë të jepet sadaka fitimi, siç është edhe njëri ndër mendimet e dijetarëve.

Fitimi i takon në këtë rast të dy palëve sikur të ishin në një biznes ortak.

Pendimi nga ky lloj i përfitimeve të ndaluara

a) Pendimi me mundësinë e kthimit tek pronari

Nëse ka mundësi që këto përfitime të ndaluara pa pëlqimin e palëve të kthehen tek pronarët e tyre nuk ka mospajtim, se pendimi nuk realizohet e as që largohet nga mëkati në fjalë përveç me kthimin e pasurisë tek pronari i saj.

Argument është hadithi, të cilin e shënon imam Ahmedi dhe Ebu Davudi nga hadithi i Saib bin Jezidit, nga babai i tij, nga gjyshi i tij, nga Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, se ka thënë: “*Mos ta marrë askush nga ju mallin e shokut të tij, duke luajtur apo seriozisht, e nese dikush nga ju*

e ka marrë shkopin e vëllait të tij le t'ia kthejë”.

b) Pendimi me pamundësinë e kthimit tek pronari

Përfituesi nga përfitimet e ndaluara është i detyruar që të pendohet dhe ai sipas xhumhurit të dijetarëve është i detyruar, që nga përfitimet e ndaluara të japë lëmoshë në interes të muslimanëve. Ai duhet që të bëjë përpjekjet maksimale, që këto shpenzime t'i bëjë në projekte sa më të dobishme dhe nuk plotësohet pendimi pos në këtë mënyrë.

c) Kthimi i përfitimeve të paligjshme tek trashëgimtarët e pronarit të saj

Tek dijetarët ekzistojnë dy mendime për ta larguar barrën nga vetja në kthimin e përfitimeve të paligjshme tek trashëgimtarët e pronarit.

Mendimi i parë: Përfituesi e largon barrën në këtë botë dhe botën tjetër, nëse ua kthen qoftë edhe trashëgimtarëve të pronarit përfitimet e paligjshme. Ky është medhhebi i Ebu Hanifes, Shafive dhe Hanbelive.

Mendimi i dytë: Përfituesi e largon barrën e tij në këtë botë e jo në botën tjetër. Ky është mendim i disa shokëve të imam Malikut dhe imam Ahmedit, Allahu qoftë i kënaqur me ta. ■

Përzgjedhi dhe përshtati: Rashit Zylfiu

KONTRATA E MIRËMBAJTJES DHE E RIPARIMIT

Kontrata e riparimit konsiderohet si një kontratë relativisht e re në legjislacionin islam, duke qenë se nuk është e shtjelluar dhe e trajtuar në librat e fikhut, si një kontratë e veçantë siç është sot, por siç është e njohur se çdo gjë që shpiket, patjetër se duhet të ketë dispozitën e vet fetare, baza e së cilës duhet gjetur qoftë në librat e hershëm të dijetarëve

PËRGATITI: LLOKMAN HOXHA

Industria ka përparuar shumë kohëve të fundit, gjë që ka sjellë edhe mjete industriale të shumta dhe të llojllojshme. Duke qenë se ato mund të dëmtohen dhe ngecin, gjë e cila ndikon negativisht në produktivitetin e tyre, është paraparë kujdesi ndaj tyre, që të jenë efektive për një kohë sa më të gjatë.

Për këtë është parë e domosdoshme që pronarët e këtyre gjësendeve të gjejnë ekspertë dhe teknikë të ndryshëm, të cilët do të kujdesen për to, t'i mirëmbajnë ato dhe të bëjnë riparimin e tyre, gjë e cila

shkaktoi që të shpiket edhe kontrata e mirëmbajtjes dhe e riparimit, si një gjë shumë e rëndësishme dhe e nevojshme në shumë sfera jetësore.

Kontrata e riparimit konsiderohet si një kontratë relativisht e re në legjislacionin islam, duke qenë se nuk është e shtjelluar dhe e trajtuar në librat e fikhut, si një kontratë e veçantë siç është sot, por siç është e njohur se çdo gjë që shpiket, patjetër se duhet të ketë dispozitën e vet fetare, baza e së cilës duhet gjetur qoftë në librat e hershëm të dijetarëve, ose me anë të përpjekjes së dijetarëve bashkëkohorë për të gjetur një vendim, i cili nuk bie ndesh me parimet islame.



Ç'është kontrata e mirëmbajtjes dhe e riparimit?

Është një marrëveshje me një kontratë të veçantë, ose në kuadër të një kontrate të caktuar, e cila bëhet në mes të kompanisë ose ekspertit dhe pronarit të gjësendit (mjet, kompjuter, celular, makinë etj), për mirëmbajtjen dhe riparimin e gjësendit në fjalë, gjatë një kohe të caktuar, me qëllim që të ruajë efikasitetin e tij, në këmbim të një shume të caktuar.

Legjitimiteti i kontratës së mirëmbajtjes dhe riparimit.

Megjithëse thamë se është një kontratë e re në fikhun islam, ajo i plotëson kriteret

“Kontrata e mirëmbajtjes në rastin e qirasë, kush duhet të mbajë përgjegjësinë e mirëmbajtjes së objektit, qiradhënësi apo qiramarrësi?... ”

që duhet t'i përmbushë një kontratë sipas parimeve islame, gjë e cila i jep legjitimitetin e saj fillimisht. Duke u bazuar në atë se rregullat dhe parimet islame e konsiderojnë, se çdo gjë e cila ka të bëjë me

çështjet jetësore në esencë është e lejuar, për derisa nuk bie ndesh me ndonjë dispozitë fetare të caktuar, dhe këtë e dëshmon:

1- Fjala e Allahu të Lartësuar:

"Ai është që për ju, ka krijuar gjithë atë që është në tokë". (Bekare: 29)

2- Si dhe fjala e të Dërguarit të Allahut (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë me të): "Muslimanët duhet t'i përmbahen kushteve që vendosin mes vete." (Ebu Davudi, Tirmidhiu, -Albani e konsideroi sahih). Pra, kjo kontratë si tërësi është e lejuar, por gjithsesi duke i plotësuar kushtet përkatëse, të cilat i kanë sqaruar dijetarët islamë, përndryshe si të gjitha kontratat e tjera, të cilat mund të jenë të lejuara, por për shkak të mosplotësimit të kriterëve fetare, ajo bëhet e ndaluar.

Kontrata e mirëmbajtjes përfshin:

1. Mirëmbajtjen, që nënkupton kontrollin periodik të gjësëdit të caktuar, për t'u siguruar në efikasitetin e tij, si dhe për të zbuluar defektet e paraqitura dhe pjesët përkatëse, të cilat duhet riparuar ose ndërruar. Qëllimi i kësaj kontrate është shmanja e defekteve të mundshme, me qëllim kursimin e shpenzimeve për riparimin e tij në rast të prishjes.

2. Riparimin, që nënkupton rregullimin (ujdisjen) e gjësëdit pas prishjes së tij. Qëllimi i kësaj kontrate është zgjatja e jetës së tij sa më shumë që të jetë e mundshme, derisa të bëhet plotësisht e paaftë, për ta zëvendësuar pastaj me ndonjë gjësënd tjetër.

3. Mirëmbajtjen dhe riparimin tok, shumica e kontratave janë të këtij lloji, dhe kur përmendet sot në qarqet komerciale si kontratë nënkupton që të dy shërbimet.

Mirëmbajtja e plotë realizon qëllimin e dy llojeve paraprake. Ekzistojnë disa forma të kësaj kontrate varësisht nga gjësëndi për

të cilin bëhet kontrata, por në korniza të përgjithshme po përmendim më kryesoret pastaj do të sqarojmë cilat janë të lejuara e cilat jo:

Forma e parë: Kontratë e mirëmbajtjes e veçantë: që nënkupton kontratën, e cila bëhet në mes pronarit të gjësëdit dhe ndonjë kompanie të caktuar për mirëmbajtjen e tij për një kohë të caktuar në këmbim të një shume të caktuar.

Kjo bëhet në tri mënyra:

a. Kontrata vetëm për mirëmbajtje d.m.th. vetëm punëdore, pa mjete, që nënkupton p.sh. ndërrimin e vajit në kohë të caktuara, pastrimin e mjeteve etj. Në këtë rast i kontraktuari mund të jetë punëtor i rregullt vetëm tek pronari, por mund të jetë privat që punon edhe për të tjerët.

b. Kontrata vetëm për punëdore, kurse mjetet (p.sh., vajin, mjetet e pastrimit, veglat e punës) përkatëse i sjell pronari.

c. Kontrata për punëdore dhe mjetet përkatëse për mirëmbajtje (p.sh., vegla të thjeshta të domosdoshme për çdo punëtor, të cilat nuk llogariten zakonisht në çmim) i sjell i kontraktuari.

Kjo formë në të tri mënyrat është e lejuar, me kusht që të dihet saktë puna që do të kryejë, koha e punës dhe mëditja ose rroga.

Forma e dytë: Kontratë e mirëmbajtjes në kuadër të shitjes së gjësëdit, që nënkupton: blerjen e një mjeti, makine etj., duke e kushtëzuar mirëmbajtjen për një çmim shtesë, por në të njëjtën kontratë të shitblerjes, pra negociohet për çmimin e mallit pastaj negociohet për çmimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe në fund mbledhet çmimi i përgjithshëm në të njëjtën kontratë.

Forma e tretë: Kontratë e mirëmbajtjes në kuadër të shitjes së gjësëdit, që

nënkupton: blerjen e një mjeti, makine etj., duke e kushtëzuar mirëmbajtjen në çmimin e shitblerjes, duke mos e rritur çmimin e mallit, për shkak të shërbimit shtesë, qoftë ky kusht nga blerësi apo shërbim nga vetë shitësi.

Forma e dytë dhe e tretë gjithashtu është e lejuar, meqë nuk kanë dallim në mes vete përveç mënyrës së caktimit të çmimit. Duke pasur parasysh gjithmonë që puna të jetë e caktuar mirë dhe çmimi të jetë i saktë, që të mos çojë në konflikt.

Forma e katërt: Kontratë e riparimit e veçantë, që nënkupton: kontratën në mes pronarit të gjësendit me ndonjë kompani të caktuar për të riparuar mjetin në rast të paraqitjes së defekteve në këmbim të një shume të caktuar përgjatë një kohe të caktuar. Pra, kontrata është për të ndërhyrë vetëm në raste emergjence dhe e pavarur nga kontrata e shitblerjes së gjësendit. Dispozita për këtë formë varet nga mënyra se si aplikohet kjo kontratë:

a. Nëse pjesët e riparimit i sjell pronari i gjësendit, apo ia paguan atij që i sjell me çmimin përkatës, ndërsa i kontraktuari kryen vetëm punën. Kjo mënyrë është e lejuar.

b. Nëse pjesët e riparimit i sjell i kontraktuari dhe pjesët zakonisht janë të papërcaktuara dhe kanë çmime të ndryshme, qoftë kontrata për mirëmbajtje (riparim) periodike apo për riparim emergjent.

Kjo formë është e ndaluar sepse i përngjan sigurimit komercial, i cili është i ndaluar, ngase pagesa bëhet përballë rrezikut, i cili mund të ndodhë, por mund të mos ndodhë. Nëse ndodh prishja, atëherë pagesa mujore ose vjetore mund të jetë shumë e ulët, kështu që i shkakton humbje të kontraktuarit, nëse nuk ka prishje fare, të hollat e pronarit shkojnë kot. Për këtë është e ndaluar.

Forma e pestë: Kontrata e mirëmbajtjes në rastin e qirasë, kush duhet të mbajë përgjegjësinë e mirëmbajtjes së objektit, qiradhënësi apo qiramarrësi? Nëse mirëmbajtja (riparimi) është nga lloji prej së cilës varet mundësia e shfrytëzimit të gjësendit të marrë me qira, atëherë kjo i detyrohet qiradhënësit, si p.sh., nëse muret janë të shtrembëruara në shtëpinë me qira duhet t'i drejtojë pronari, nëse vetura ka defekte në makinë pa fajin e qiramarrësit këtë duhet ta rregullojë pronari, sepse këto janë gjëra pa të cilat nuk mund të shfrytëzohet objekti për qira, dhe nuk lejohet të ngarkohet me të qiramarrësi.

Ndërsa mirëmbajtja ngaqë është nga lloji i cili nuk varet nga ai mundësia e shfrytëzimit, si lyerja e mureve të shtëpisë, ndërrimi i vajit të makinës, materiale harxhiuese etj., gjëra të cilat nuk pengojnë mundësinë e shfrytëzimit të objektit për qira, lejohet t'i kushtëzohet qiramarrësit po edhe qiradhënësit, sipas marrëveshjes, me kusht që të jetë çdo gjë e përcaktuar mirë dhe qartë. Pra nuk i takon qiradhënësit të përkujdeset për mirëmbajtjen operative, përveç nëse kjo shënohet në kontratë, po ashtu nuk lejohet të ngarkohet qiramarrësi me riparimet kapitale, përveç nëse ai është shkaktar direkt dhe i qëllimshëm i dëmit përkatës.

Forma e gjashtë: Kontrata e mirëmbajtjes e shoqëruar në kontratën e sipërmarrjes. A lejohet t'i kushtëzohet sipërmarrjes mirëmbajtja e gjësendit të prodhuar, si p.sh. një sipërmarrje të marrë me kontratë ndërtimin e një objekti dhe mirëmbajtjen e tij, apo një makine dhe mirëmbajtjen e saj, për një kohë të caktuar me një çmim të caktuar, kjo formë është e lejuar, ngase mirëmbajtja është kusht dhe çmimi i kontratës bazë e përfshin edhe atë. ■

NË MENDJEN E FËMIJËS MUSLIMAN

Grupi i miqve dhe shokëve inkurajojnë adoleshentët për të sfiduar prindërit, duke u mbështetur në forcën e atij grupi të ri në të cilin ai bëhet anëtar. Ky grup e mbështet atë për të demonstruar atë sfidë, dhe i jep atij përshtypjen e përgatitjes psikologjike të cilën ai nuk e pranon nga familja e tij,

<http://www.islamweb.net/islamweb.net>

Dimensioni që mungon në metodat e edukimit: *Edukimi i ndjenjave (edukimi sentimental).*

Edukimi i ndjenjave ka të bëjë me ndjenjat e personit, të cilat formojnë të gjitha anët e personalitetit të integruar të njeriut.



“Në familje, fëmijët mësojnë si të kontrollojnë dëshirat e tyre dhe shtypin prirjet e tyre që nuk pajtohen me shoqërinë...”

Fjala *sentimentalitet* ka të bëjë me çdo ndjenjë të kënaqësisë ose dhimbjes, si dhe gjendjes së caktuar psikologjike brenda kënaqësisë dhe dhimbjes, karshi gjendjeve tjera brenda perceptimit mendor dhe logjikës.

Bazuar në këtë, të gjitha ndjenjat në vetëdijen e njeriut, dhe ndjenjat e rezultuara nga kënaqësia dhe dhimbja, së bashku me ndjenjat pozitive dhe negative, përbëjnë ndjenjat e njeriut.

Edukimi i ndjenjave, sipas mendimit tim, është ajo që ndihmon në zhvillimin e ndjenjave dhe shqisave të tilla në mënyrë pozitive, që përfundimisht shpie në marrëdhënie konstruktive me njerëzit, universin dhe jetën.

Edukimi i ndjenjave, sikurse format e tjera të edukimit, është i bazuar në një grup shtyllash:

1 - Familja: Familja është inkubatori themelor në të cilin

individit dhe e gjithë sjellja e tij është formuar, në bazë të të cilave, qëndrimet e tij janë të ngritura në përgjithësi. Familja është institucioni social më i rëndësishmi që ndikon në personalitetin e qenies njerëzore. Ajo pranon njeriun e porsalindur dhe mbështet atë gjatë periudhave më të rëndësishme të jetës së tij: periudha e fëmijërisë. Siç është thënë nga psikologët, kjo është periudha 'kritike' në ndërtimin dhe formimin e personalitetit të njeriut. Kjo është ngase ajo është një periudhë konstruktive dhe themelore.

Në një hadith të Dërguarit të Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i referohet këtij fakti: "*Çdo fëmijë lind me natyrshmërinë e tij të pastër, në fenë e vërtetë (Islame), e pastaj prindërit e tij e kthejnë në judaizëm, krishterizëm apo paganizëm*"

Brenda mjedisit familjar, prindërit e formojnë fëmijën, dhe përcaktojnë qëndrimet e tij themelore, të cilat janë orientime të tij të besueshme. Pra, familja luan një rol kryesor dhe të rëndësishëm në formimin e sjelljes, besimit dhe personalitetit të individit, e cila i jep atij sjellje të tjera më pas. Në familje, fëmijët mësojnë si të kontrollojnë dëshirat e tyre dhe shtypin prirjet e tyre që nuk pajtohen me shoqërinë. Në këtë mënyrë, themelet e përshtatjes sociale nguliten, duke u mbështetur në funksionin edukativ brenda atmosferës familjare. Prandaj, nuk është për t'u habitur të theksohet rëndësia e madhe e familjes që i kanë dhënë ata të cilët kryejnë hulumtime në lidhje me "tërbimin" e të miturve, si një nga boshtet kryesore në të cilën ata përqendrojnë hulumtimet e tyre, në përpjekje për të zbuluar shkaqet dhe faktorët e tërbimit dhe padëgjueshmërisë. Pa dyshim, familja e shpërbërë është faktori kryesor përgjegjës për delinkuentët e mitur dhe

për sjelljen jonormale, dhe një inkubator i përshtatshëm për prodhimin e adoleshentëve të vonuar.

2 – Shkolla: Kjo renditet e dyta për nga rëndësia në aspektin e edukimit, posaçërisht pasi arsimimi është bërë publik dhe vitet e para janë bërë të detyrueshme në shumicën e vendeve. Shkolla merr përsipër procesin e mësimdhënies së fëmijëve, në bashkëpunim me familjen, me qëllim të zgjerimit të mjeteve të perceptimit, dhe ndihmon ata të përfitojnë njohuri dhe studim. Si pasojë, shkolla ka dal si institucion i rëndësishëm shoqëror, i cili ka ndikim efektiv te fëmija në të gjitha aspektet psikologjike, sociale, morale dhe të sjelljes.

Kjo i kthehet faktit se gjatë viteve të tij të para, fëmija është i predispozuar për nga natyra, të imitojë dhe kërkon vlerat e dala nga shkolla dhe shoqëria në të cilën ai jeton. Kështu, shkolla është një faktor i rëndësishëm që ka një ndikim të madh në formimin e personalitetit të individit, në mënyrë të shëndoshë shkencore dhe edukative, dhe në vendosjen e qëndrimeve dhe marrëdhënieve të tij të ardhshme në shoqëri. Shkolla, pra, nuk është vetëm një inkubator për të dhënë informacione, por ajo gjithashtu është një strukturë e komplikuar e raporteve, veçanërisht për fëmijët e vegjël.

Në shkollë, rrethi social i fëmijës përfshinë fëmijë të rinj dhe grupe të reja, dhe ai mëson, në atmosferën e saj, "më shumë standarde sociale në forma sistematike, dhe funksione të reja shoqërore. Ai mëson të drejtat dhe detyrat e tij, mënyrën për të rregulluar emocionet e tij dhe përshtatur nevojat e tij me atë të të tjerëve. dhe bashkëpunimi, së bashku me disiplinën e sjelljes."

Fëmija mëson gjithë këto nëpërmjet informacionit që ai merr dhe fiton si rezultat i përzierjes me shokët e tij të shkollës. Në përgjithësi, shkolla ka ndikimin e saj efektiv në sjelljen dhe orientimet e ardhshme të fëmijëve. Përmes shkollës, ne jemi në gjendje për të zbuluar simptomat e hershme të delikuençës, e cila jep zgjidhje të hershme të tyre para se të bëhet më keq: Dua të them simptoma të tilla si dëmtimi i shokut të shkollës, vjedhja, përpjekja për të ikur nga shkolla, ose dëmtimi i pronës shkollë, të gjithë nga këto janë indikator të mungesës së sjelljes së fëmijës.

3 – Rrethina: Kjo është, vendi ose zona gjeografike në të cilën familja jeton në lagjen e shumë familjeve të tjera, ku rrjeti i raporteve shoqërore është i vendosur në mes familjeve të ndryshme dhe anëtarëve të tyre në kushte të kontaktit reciprok efektiv dhe ndikues.

Për këtë arsye, lagja kontribuon në sigurimin e individuale me disa vlera të sjelljes, situatave, qëndrimeve dhe standardeve që i përkasin kornizës së përgjithshme civilizuese të zonave shoqërore.

4 – Shokët (shoqëria): Elementet e personalitetit dhe sjelljes së fëmijës janë të formuara nëpërmjet disa faktorëve ndikues. Ndonëse, prej tyre familja dhe shkolla janë ndër më të shquara, miqtë dhe shokët e tij nuk janë më pak të rëndësishëm. Përkundrazi, ndikimi i shokëve ndonjëherë mund të jetë më i fortë se elementet e tjera. Grupi i miqve dhe shokëve inkurajojnë adoleshentët për të sfiduar prindërit, duke u mbështetur në forcën e atij grupi të ri në të cilin ai bëhet anëtar. Ky grup e mbështet atë për të demonstruar atë sfidë, dhe i jep atij

përshtypjen e përgatitjes psikologjike të cilën ai nuk e pranon nga familja e tij, qoftë të jenë të rinj apo të vjetër.

Në këtë mënyrë, grupi i shokëve është njëri nga burimet më të rëndësishme të favorizuara nga adoleshentët për të imituar, dhe për të marrë opinione dhe mendime. Islami e njeh dhe i referohet rëndësisë së shoqërisë dhe miqësisë së dikujt, dhe ndikimin e saj në jetën e individit, në aspektin e marrjes së vlerave, sjelljes dhe mendimeve. Në lidhje me këtë, është transmetuar nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ai ka thënë: I dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selam*, ka thënë: **“Njeriu është në fenë e shokut të tij, pra secili nga ju shihni se kë po miqësoni”**. Nëse ndikimi i shokut arrin edhe te feja atëherë, pa dyshim, ndikimi i tij në sjellje dhe qëndrime është më i qartë dhe më evident. Nëse ky është ndikimi i vetëm njërit, atëherë, çka mendoni për ndikimin e një grupi? Me siguri, ndikimi i tyre në fëmijën ose adoleshentin është më i fortë.

Kjo nuk është e çuditshme se grupi i shokëve ka një ndikim të fortë. Në një ekip, fëmija mëson se si të jetojë në një atmosferë grupore të klasës së re dhe marrëdhënie të reja shoqërore, ku nuk mund të mos pajtohen me ta, në të kundërtën, ai do të jetë i refuzuar nga grupi. ■

Nga anglishtja: Drita Maliqi

KËSHTU NËNSHTROHET DYNJAJA





Enes ibën Maliku përmend se e ka dëgjuar Profetin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë: “Kush synon ahiretin (botën tjetër) Allahu ia bashkon (zvogëlon) problemet, ia mbjell pasurinë në zemër dhe i vjen dynjaja nga pas, edhe pse nuk dëshiron (që t’i vijë). Ndërsa kush synon dynjanë (këtë botë) Allahu do t’ia shpërndajë (shumojë) problemet, ia vendos varfërinë mes syve të tij dhe nuk i vjen nga dynjaja më shumë se ajo që i është caktuar (në kader).”

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Zinxhiri i hadithit: Hadithin e transmeton Enes ibën Maliku dhe Zejd ibën Thabiti. Kurse e shënon imam Ahmed në Musned, 5/183, Ibën Maxhe në Sunen, Darimiu në Musned, Ibën Hibani nr. 82 dhe 83 etj. Ky hadith konsiderohet i saktë në bazë të senedit (zinxhirit të trans-

metuesve), i cili e përcjell atë. Atë e saktëson Ibën Hibani, kurse Busiri thotë: “Ky zinxhir i hadithit është i saktë.” (Ez-Zeuaid, 252/1). Të njëjtat fjalë rreth saktësisë së tij i përmend edhe Shejh Albani, Allahu i mëshiroftë të gjithë, në librin e tij: Silsile sahiha, hadithi nr. 404.

Komentimi i hadithit: Dhënia pas dynjasë është njëra nga dy sprovat më të mëdha me të cilat mund të pushtohet njeriu dhe të harrohet pas saj. Allahu e ka bërë dynjanë të bukur, të hijshme, aq sa nëse ai nuk është i vetëdijshëm ajo e përmbledh me vete duke e larguar nga Zoti dhe duke e hedhur në zjarr. Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e përshkruan dynjanë me këto fjalë: “*Dynjaja është e ëmbël dhe e gjelbëruar (zbukuruar) në të cilën Allahu ju bëri përgjegjës për të parë se çfarë do të punoni, kështu ruajuni nga dynjaja dhe nga gratë.*” (Muslimi).

Hadithi në fjalë në vetvete përmend disa pika të rëndësishme, që tregojnë se cilat janë pasojat e dhënies pas dynjasë dhe në të kundërtën cilat janë dobitë e dhënies pas ahiretit. Hadithi përmend:

-Dobinë e dhënies pas ahiretit

-Fitnen dhe rrezikun e dynjasë

-Forma e vetme se si të mposhtet dynjaja dhe të fitores mbi të.

Duke mos harruar se dobitë e interesimit pas ahiretit dhe largimit nga dynjaja nuk janë vetëm këto që përmenden në këtë hadith, por ato janë më shumë se kaq, por pasi janë përmendur vetëm këto në hadith ne do të mjaftohemi me to dhe janë të bollshme për atë që dëshiron të kuptojë.

Besimtari që ka si qëllim të jetës së tij fitimin e Xhenetit dhe punon për të, ai ndër të tjera do të përfitojë edhe në këtë dynja, duke mos i munguar asgjë prej saj, duke mos u dalluar prej të tjerëve, por përkundrazi jeton më mirë se ta, është më

“...Edhe pse besimtari i largohet dynjasë është për t’u habitur se si ajo i shkon nga prapa ...”

i qetë, përfiton të gjitha të mirat e kësaj bote, duke mos u munduar shumë pas tyre dhe në anën tjetër e fiton edhe Xhenetin. Njeriu që me jetën e tij ka synuar arritjen e shpërblimit dhe të Xhenetit ndër të tjera në këtë hadith përmendet se do të përfitojë edhe:

“Allahu ia bashkon (zvogëlon) problemet”

Kjo do të thotë se atij nuk i përzihen e as nuk i dalin prej dore punët e tij, çdo gjë e ka të programuar dhe ecën sipas nevojës, duke mos lënë mangut asgjë nga ajo që i nevojitet. Zvogëlimi i problemeve nuk është i përcaktuar vetëm me ato të dynjasë, por është i përgjithësuar, duke na dhënë të kuptojmë se në të futen të gjitha dertet, si ato të kësaj bote, ashtu edhe të varrit, Ditës së Gjykimit dhe të botës tjetër. Pa dyshim se kush e bart dertin e asaj për çka është krijuar dhe për çka ka ardhur në këtë botë, që të interesohet për të, atëherë tjetër kush do t’i bartë dertet e tjera të këtij njeriu dhe do t’ia rregullojë ato, e ai është Allahu i Gjithëmëshirshëm.

Përmendet se atij të gjitha punët i shkojnë mbarë dhe i mblidhet çdo e mirë, i mblidhet mendja, truri i qëndron i përqendruar, i mblidhet familja dhe fëmijët në devotshmëri dhe rreth tij, i mblidhet paraja, i mblidhen në dashuri zemrat e të tjerëve, duke filluar ta duan, ta respektojnë etj.

Pra, në përgjithësi i mblidhet rreth veti çdo e mirë e kësaj bote dhe e botës tjetër.

“ia mbjellë pasurinë në zemër”

Shumë njerëz mendojnë se pasuria është paraja, duke mos e ditur se pasuria e vërtetë është pasuria e zemrës e jo e xhepit. Për këtë rregull Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: “Pasuri nuk konsiderohet malli i shumtë, por pasuri është pasuria e shpirtit.” (Tirmidhiu, Ibën Maxhe-sahih)

Pasuria shpirtërore do të thotë është kënaqësia e njeriut me atë që i është caktuar nga Allahu dhe me atë që e ka në duar të tij duke mos lakmuar në atë që e kanë të tjerët, duke mos harruar se kjo nuk do të thotë mosinteresimi për pasuri. Njeriu i tillë nuk jepet pas dynjasë, nuk interesohet për atë që s’është e tij, nuk u lyp të tjerëve, por vetëm Zotit, e ka shpirtin e ngopur, nuk ka ëndje për atë që është e huaja. E tërë kjo vjen si pasojë se ai synim të tij ka ahiretin, i cili është në Duar të Allahut e jo atë që të tjerët e kanë në duart e tyre.

Njeriu të cilit i mungon pasuria shpirtërore atij edhe sikur t’i ketë me miliona të hollat e depozituara do ta shihje se në fakt është i varfër në shpirt, në sjellje, në bashkëpunim me të tjerët, është i pakënaqur me atë që ai zotëron dhe mundohet që të tërë dynjanë ta fusë në duart e veta, ëndje kjo e cila e nxit që të largohet nga rruga e Allahut, për shkak se është i zënë pas grumbullimit të parave. Pra i pasur është ai që e bind veten se ka nevojë për Allahun e jo për paratë, ai që mendon se është i varur nga Zoti dhe jo nga të hollat pa marrë parasysh ky njeriu se sa të holla zotëron, kurse i varfër është ai që mendon se ka nevojë për të holla, beson tek to dhe jepet pas tyre, duke e harruar Allahun dhe nevojën për Të.

“...Vrapon pas parasë, pas autoritetit, pozitës e emrit, por prapë nuk i vjen më shumë se sa i është caktuar...”

“i vjen dynjaja nga pas edhe pse nuk dëshiron (që t’i vijë)”

Besimtari nuk jepet pas lezeteve të dynjasë, sepse e di se ato janë të përkohshme, janë mashtruese dhe kjo do të ndikojë që ta pengojë nga arritja e kënaqësisë së Allahut dhe shpërblimit të Tij. Duke qenë i vetëdijshëm për këtë gjë, edhe i rri larg asaj, frikësohet prej saj sikurse frikësohet nga dallgët e mëdha të detit, të cilat përmbledhin para vetes çdo gjë që u del përpara. Ai e di se Xhehenemi është i zbukuruar me lezetet e kësaj dynjaje, të cilat kush mundohet t’i provojë dhe t’i arrijë të gjitha ato pak nga pak do ta çojnë në destinacionin e padëshiruar, pra në Zjarr.

Megjithatë edhe pse besimtari i largohet dynjasë është për t’u habitur se si ajo i shkon nga prapa dhe çdo gjë që Allahu ia ka shkruar për ta pasur dhe poseduar nga ajo i vjen këtij besimtari, edhe pse vetë dynjaja nuk ka dëshirë që t’u shkojë nga pas atyre që nuk e duan, por rregulli i Zotit për të është asisoj, që ajo të shkojë pas çdokujt që nuk e do dhe e kundërta të largohet prej çdokujt që e dashuron dhe jepet pas saj. Shembulli i dynjasë është si ai i hijes së njeriut, të cilën njeriu nëse e ndjek hijen e vet në një shesh të hapur kurrë nuk e arrin atë, sepse ajo ikën para tij dhe e kundërta, nëse largohet dhe ia

kthen shpinën hija është ajo që e ndjek, duke mos u larguar kurrë prej tij.

Në të dy rastet tona në këtë hadith, si besimtari, si pasuesi i dynjasë, që të dy nuk do të arrijnë prej saj asgjë më shumë, se sa ajo që iu është shkruar apo caktuar nga Allahu, që kur kanë qenë në barkun e nënës së tyre. Megjithatë që përmendëm në këtë pikë duhet pasur kujdes fakti, se Allahu nuk do nga besimtari që të vdesë për bukë, për ujë apo ilaçe. Ai duhet ta shfrytëzojë dynjanë për aq sa ka nevojë për të, të punojë dhe të angazhohet, por ky angazhim të jetë për t'i shërbyer qëllimit final, të cilit muslimani ia ka vendosur vetes. Ai duhet ta vendosë dynjanë në shërbim të ahiretit të tij, ta shfrytëzojë aq sa ka nevojë për të, duke i ngjarë kështu shembullit të udhëtarit nëpër shkretëtirë, ngase edhe dynjaja është rrugë përmes shkretëtirës. Udhëtari ndalet nën hijen e pemës së rastit, të cilën e shfrytëzon sa ka nevojë për të e pastaj largohet duke e vazhduar rrugëtimin e tij. Pra, ai e shfrytëzon hijen jo për hir të vetë hijes, por e vendos në shërbim të qëllimit të tij dhe për hir të rrugëtimin që ai ka marrë. Kështu duhet shfrytëzuar dynjaja jo për hir të saj, por për hir të ahiretit, duke e vënë në dispozicion dhe shërbim të ahiretit. Në të kundërtën ai që e synon dynjanë ai e ka qëllim që ta ndërtojë dhe të punojë për të, sikurse udhëtari të jepej pas ndreqjes dhe rregullimit të asaj peme dhe hijes, kështu atij do t'i ikte koha e pushimit, ndërsa nga ana tjetër, nëse do ta rregullonte mirë do të ndalej tek ajo hije dhe ta anulonte udhëtimin e tij për atje ku është nisur, e njeriu që prej lindjes së tij është nisur për diku, kjo rrugë ka vetëm dy stacione: Xhenetin ose Xhehenemin.

Në të kundërtën e kësaj që sapa u përmend deri tani është njeriu që jepet pas kësaj dynjaje dhe qëllimi i jetës së tij është

“Njeriu kurrë nuk ngopet përveç nëse nuk lakmon...”

ta arrijë atë, të kënaqet në të dhe nuk mendon se a ekziston diçka pas saj apo jo. Njerëzit e tillë Allahu i dënon me shumë të këqija, të cilat përmenden në disa referenca në Kuran e Sunet, kurse në hadithin tonë në fjalë veçohen me përmendje tri prej tyre, të cilat janë:

1- “Allahu do t’ia shpërndajë (shumojë) problemet”

Atij çdo gjë që e ka pasur nën kontroll i del nga kontrolli, i përhapen dhe shumohen problemet, asnjë punë nuk mund ta kryej me rregull, gjithmonë është i mangët, me vërejtje dhe parregullsi në atë që punon. Njerëz të tillë nuk kanë sukses në asnjë punë, ardhmërinë e kanë të zymtë, nuk dalin fitimtarë e as të kënaqur me askënd, bile edhe me familjet e veta janë në kundërshtim dhe të përçarë, pra, është në shumë telashe edhe pse mund të mendojë se i ka punët mirë. Atij i mjafton që me Allahun nuk qëndron mirë, i mjafton se Zoti është i zemëruar dhe i pakënaqur me të.

2- “varfërinë ia vendos mes syve të tij”

Me këtë fjali nënkuptohet se ai jo vetëm që është i varfër në zemër, kjo është mëse e sigurt, por ajo e përcjell në çdo kënd, i është vendosur mes syve të tij. Kjo vendosje mes syve simbolizon faktin se ai gjithmonë e sheh para syve do të thotë gjithmonë i kujtohet varfëria, frikësohet prej saj dhe kurrë nuk është i qetë, e sikur vetëm ta kishte në zemër këtë frikë nga varfëria ndoshta ndonjëherë do ta har-

ronte, por ja që nuk mund ta harrojë, sepse i qëndron para syve. Një njeriu të tillë nuk i duhet pasuria kur është gjithmonë i frikësuar dhe në stres të varfërisë. Kështu është me atë, i cili jepet pas dynjasë, e synon atë dhe punon pandërprerë për të, duke e harruar Allahun e botën tjetër. Në raste të tilla është interesant fakti se persona të tillë e kanë harruar Allahun dhe mundohen me çdo kusht të arrijnë pasurinë e dynjasë e në fakt Allahu ua kthen me të kundërtën e asaj që ata synojnë, pra, ua kthen me varfëri të pandërprerë, me stres të vazhdueshëm.

“nuk i vjen nga dynjaja më shumë se ajo që i është caktuar (në kader)”

Ky person edhe pse vrapon pas dynjasë ai prapë nuk arrin të fitojë asgjë më shumë se sa ia ka caktuar Allahu në kaderin (caktimin) e Tij. Kështu që një njeri i tillë humb shumë gjëra, dhe jeton me shumë probleme dhe të gjitha këto vetëm për shkak të dhënies pas dynjasë e në fakt i shkreti nuk ka asnjë mundësi që të arrijë më shumë, se ajo që i është caktuar nga Allahu. Vrapon pas parasë, pas autoritetit, pozitës e emrit, por prapë nuk i vjen më shumë se sa i është caktuar. Për këtë arsye nuk duhet ta harrojmë veten pas këtyre gjërave, sepse paraja, autoriteti, karrigia, emri dhe dynjaja do të vijnë, aq sa të është caktuar nga Allahu që para lindjes do të vijnë, deshën apo nuk deshën këta njerëz, por për besimtarin me rëndësi është të jepet pas ahiretit.

Në fund mos harro:

-Nënshtroje dynjanë e jo ajo ty. Ky nënshttrim arrihet vetëm me një mënyrë, duke mos u dhënë pas saj.

-Pasuria e muslimanit është në pasimin e fesë e jo të kësaj bote, sepse dynjaja sado e ëmbël të jetë prapë i vjen fundi, kurse

ahireti është i pafund.

-Dynjanë fute në duar, por jo në zemër, robëroje atë e jo ajo ty.

-Të jesh i pasur nuk është në kundërshtim me këtë që përmendëm deri tani, por të harrohesh pas saj dhe të largohesh prej fesë është në kundërshtim me këtë që u tha.

-Në këtë botë jemi krijuar për të mbjellë e jo për të korrur. Ahireti është ai në të cilin korret ajo që mbillet këtu. Kush mundohet ta bëjë të kundërtën nuk mund të marrë asgjë nga puna e tij, sepse nuk ka në botë askund që të korrësh para kohe apo para se të mbjellësh.

-Askush nuk e harxhoi e as e mori me vete këtë dynja, prandaj merr mësim nga të parët e mos u mashtro.

Njeriu kurrë nuk ngopet përveç nëse nuk lakmon. Lakmitari po ta ketë një luginë me flori do ta kërkojë të dytën e pastaj të tretën e kështu me radhë, kështu biri i Ademit nuk ngopet me asgjë përveç se me dheun që i futet në gojë pasi të hyjë në varr, siç na mëson Profeti ynë, *sal-lallahu alejhi ue selem*.

Bëhu asket ndaj dynjasë të do Allahu dhe bëhu asket ndaj asaj që kanë njerëzit do të duan ata. ■

DEKODIMI SHKENCOR I KURANIT

Meditimi im për këtë ajet ka filluar pas bisedës telefonike me një mikun tim të dashur, i cili më pyeti a thua dikush prej ulemave ka llogaritur se sa kokrra gruri ka, nëse nga shtatë kallinj mbijnë njëqind kokrra, p.sh. pas pesë viteve?

PRIM. DR. MED. SC. ALI F. ILJAZI

A mundet një ide ta ndryshojë botën, dhe çfarë thotë Kurani për këtë? A mundet një ide ta shpëtojë njeriun? Sa kohë nevojitet, duke llogaritur në veprimin e progresionit shtatëfishor të Kuranit, që ideja e këtij punimi të arrijë deri te gjashtë miliard njerëz? Si funksionon progresioni shtatëfishor i përmendur kur kemi të bëjmë me bimët, të hollat dhe idetë?

Në Kuranin Fisnik Allahu i Madhërisëm thotë: ***“Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e Allahut është si i një kokrrë që i mbinë shtatë***

kallinj, në secilin kalli njëqind kokrra. Allahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, Allahu është bujar i madh, i di qëllimet.” (Bekare, 261).

Meditimi im për këtë ajet ka filluar pas bisedës telefonike me një mikun tim të dashur, i cili më pyeti a thua dikush prej ulemave ka llogaritur se sa kokrra gruri ka, nëse nga shtatë kallinj mbijnë njëqind kokrra, p.sh. pas pesë viteve? Kam hulumtuar punimet e mbi dhjetë komentuesve klasikë të Kuranit për këtë çështje dhe kam parë, që në këtë ajet kanë shikuar vetëm nëpërmjet prizmit të shpërblimit të shumëfishtë të Krijuesit. Askush nga ata nuk është preokupuar me



numrin e saktë, ose implikacionet e gjera të ajetit.

Studentët e matematikës janë të njohur me llogaritjen matematikore të kokrrave të hashashit. Nëse një bimë e hashashit ka 3.000 kokrra dhe nga secila kokërr mugullon nga një bimë edhe me 3.000 kokrra, nëse shumëzimi i hashashit vazhdon me këtë progresion, për katër deri pesë vjet e tërë toka e planetit tonë do të mbulohej me hashash. Dikush mund të thotë, ëndrra të çuditshme të hashashit!

KRUJIMI I KAPITALIT FINANCIAR

Duke folur për numrat është interesant

të përmendim llojin e shpërblimit që kërkoi nga mbreti zbuluesi i njohur i lojës së popullarizuar të shahut. Mbreti i mahnitur me lojën, me zemërgjerësi i ofroi zbuluesit të kërkujë shpërblim çfarë të dëshirojë. Ky me “modesti” i tha që dëshiron në gjithë 64 katrorët e shahut kokrra gruri, kështu që duke filluar nga katrori i parë, në secilin katror tjetër të marrë vlerën e dyfishtë të fushës së mëparshme. Gjegjesisht, në fushën e parë të marrë një kokërr gruri, në të dytën dy, në të tretën katër, në të katërtën tetë, në të pestën 16, në të gjashtë 32 etj. Mbreti qeshi për shkak të kësaj kërkese modeste, duke mos menduar shifrat, të cilat mund

të fitohen në fund në këtë progresion.

Shifra e cila fitohet në 64 katrore shahu, duke pasuar progresionin e përmendur, është 18.446.744.073.709.551.615 kokrra gruri. Kur ky numër kuadrilion shumëzohet me peshën e një kokrre gruri, fitohen 460 miliard ton gruri e që është më shumë se korrja njëmijëvjeçare e grurit në të tërë botën.

I tërë dimensionin e këtyre numrave mund të përjetohet, nëse i paraqesim në mënyrë plastike. Kjo do të ishte, thonë ekspertët, nëse do të kemi një hambar të gjatë 10 metra, 4 metra të lartë, i cili zgjerohet nga planeti Tokë e deri te Dielli (largësia prej Tokës deri te Dielli është afro 150 milion km) dhe prapa. Numri i kokrrave të grurit të përmendura në progresionin shtatëfishor në Kuran është edhe më impresionues.

Vini re! Do të njehsojmë vetëm numrin e kokrrave të grurit nga një kalli dhe do të arrijmë deri te numri fantastik.

Nëse nga një kokërr mbijnë shtatë kallinj dhe në secilin kalli ka 100 kokrra, këto janë 700 kokrra. Nëse nga secila kokërr mbijnë edhe shtatë kallinj dhe në secilin kalli nga 100 kokrra, fitojmë numrat në vijim për katër vite, nëse është fjala për një korrje në vit:

Pas një viti nga një kokërr do të fitojmë $7 \times 100 = 700$ kokrra.

Pas dy viteve: $700 \times 700 = 490.000$.

Pas tri viteve: $490.000 \times 700 = 343.000.000$.

Pas katër viteve: $343.000.000 \times 700 = 240.100.000.000$.

Meqë sipërfaqja e tokës është

$148.280.000.000 \text{ m}^2$, numri i kokrrave të grurit që do të fitojmë pas katër viteve vetëm nga një kalli gruri, me progresion shtatëfishor, mjafton që të mbillet dendur

“Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue selem që ka thënë: “Sikur ju të mbështeteni tek Allahu singërisht, Ai do t’u jepte furnizim siç u jep shpezëve, të cilat në mëngjes fluturojnë të uritura e në mbrëmje kthehen të ngopura.” ...”

çdo metër katror i Planetit! Natyrisht numrin përfundimtar e paramendojmë në kushte ideale, d.m.th. në kushtet e mungesës së plotë të dëmtuesve: minjtë e fushës, shirat, acari, thatësia dhe indiferenca njerëzore.

Zoti i Gjithëdijshëm i botëve ofron analogjinë me progresionin shtatëfishor madhështor në kontekstin e të hollave. Për ndryshim të grurit (bimëve), i cili biologjikisht është i aftë dhe zhvillohet e shumohet, të hollat nuk janë. Ai i cili e paramendon këtë fakt, e kupton gabimisht këtë ajet vështirë se mund të shërbehet me te. Por në çfarë mënyre atëherë funksionon mesazhi në këtë ajet?

Të shikojmë para kësaj, si funksionojnë mesazhet në hadithin vijues, i cili po ashtu është i lidhur ngushtë me shumimin e kapitalit ekzistencial. Omer ibën Hatabi transmeton nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue selem që ka thënë: “Sikur ju të mbështeteni tek Allahu singërisht, Ai do t’u jepte furnizim siç u jep shpezëve, të cilat në mëngjes fluturojnë të uritura e në mbrëmje kthehen të ngopura.” (Tirmidhiu). Fjala kyçe në këtë hadith

është: “...në mëngjes fluturojnë!”, sepse udhëzon në kërkim me kohë për rastet e rëndësishme.

E ku fluturojnë? Nga foleja të cilën me mund dhe durim e ndërtojnë! Le të vështrojmë shkurtimisht çfarë i nevojitet një trumcaku të ndërtojë një çerdhe mesatare. Një shkencëtar gjerman ka llogaritur që një fole e trumcakut përmban nga 630 qime të gjata të kalit, 1.715 qime të shkurtra, 195 copëza balte, 3 gjethe të mëdha, 20 gjethe të madhësive të ndryshme, 45 gjëra mëndafshi, dhe 35 gram lesh deleje. Për të qenë foleja kompakte dhe e banuar, i gjithë materiali duhet lidhur me pështymën e zogut, që e prodhon në organizmin e tij. Fluturimin nga foleja ia mundëson në mes të tjerash edhe ushqimi i përshtatshëm, dëshira e madhe dhe synimi i qartë.

Para se të kthehemi në folenë e tij, në të mes tjerash analizon çdo centimetër katror të sipërfaqes së tokës nëpër të cilën fluturon dhe me shpejtësi shfrytëzon rastet e njohura. Nëse hasin në arrë të fortë dhe lajthi, nuk shërbehen me lutje pasive, por shërbehen me fuqinë automobilistike duke hedhur në cak arrat dhe lajthitë në autorrugët e frekuentuara. Pas kësaj kthehen në çerdhe të ngopur dhe natyrisht gjatë tërë këtij procesi mbështeten tek Zoti i tyre.

Kthehemi tani tek ajeti në fillim dhe mënyrën e funksionimit të progresionit shtatëfishor. Nëse e japim 1 euro (ose një projekt vullnetarisht, shërbim që nuk do ta paguajmë) sinqerisht në emër të Allahut, gjegjësisht për një qëllim të lartë në të cilin nuk ka absolutisht asnjë interes personal, Allahu i Madhërishëm na shpërblen për këtë mirësi në atë mënyrë që si kthim na ofron shtatë koncepte financiare të volitshme, ndërsa në secilin

nga këto koncepte nga 100 ide biznesi ose projekte.

Nga ne pritet natyrisht, që këto koncepte dhe ide biznesi t'i njohim, shënojmë, përpunojmë, të konsultohemi me ekspertët, riarsimojmë, t'i masim me parametra preciz të ideve me shansin më të madh të praktikimit, duke marrë parasysh afrimin dhe kërkimin e vendit konkret dhe kohës etj., dhe të lëvizim në realizimin e tij. Kapitali i arritur nga ideja realizuese kërkon fisnikërim dhe qarkullim të mëtejshëm nëpërmjet projekteve të rinj, përndryshe progresioni ndalet. Edhe pse për një dhënie të sinqertë të hollave, gjegjësisht projekt të zhvilluar në emër të Allahut, dhënësi fiton si shpërblim raste të paparashikuara për zhvillim financiar, fare pak ka të tillë që me kohë i njohin këto raste duke vepruar me mjaft mençuri dhe shpejtësi.

Mënyrën si na i ofron Krijuesi i Urtë konceptet e përmendura dhe idetë, vërehet në tablonë e gjerë të shenjave në veten tonë dhe rreth nesh, mesazheve, imazheve, mendimeve etj.

Shumica e këtyre shenjave të përmendura dhe shanseve në shikim të parë duken të thjeshta dhe njerëzit presin shanse të arta duke shikuar në distanca të mëdha, i lëshojnë duke u sjellë ndaj tyre plotësisht me shkapërderdhësi, ndërsa shkapërderdhësit kanë afinitet ndaj varfërisë, siç thotë ajeti fisnik:

“Ata që shpenzojnë tepër (mastrafxhinjtë) janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të Tij.” (Israë, 27). ■

UDHËZIME NË RAST SITUATASH PROBLEMATIKE PËR MUSLIMANIN

ZGJODHI E PËRKTHEU: MIRSIM MALIQI

Pyetje: Ne jetojmë në Suedi; dhe atje shumë burra i shkurorëzojnë gratë e tyre në gjyq nëpërmjet letrave (shkresave), gjegjësisht pa shqiptuar shprehje divorci dhe këtë e bëjnë duke synuar të marrin dy banesa dhe dy rroga të veçanta, por ata megjithëkëtë pastaj bashkëjetojnë në njërën prej shtëpive, e tjetrën e japin me qira; divorci në këtë rast, a është në fuqi?!

E nëse rast se konsideroni se nuk është, atëherë a lejohet që të jetojë aty dhe të bëjë dredhi ndaj kushtetutës në këto vende, në vend që t'u shfaqë atyre moralet e larta islame dhe t'i ftojë në Islam?!

Përgjigje: Lavd-falënderimi i takon Allahut!

Së pari: Kur njeriu divorcin e shkruan qartazi në një shkresë dhe vërtetë ka për qëllim këtë divorc, atëherë ai është në fuqi, sipas pajtimit të të gjithë fukahave



DICTEA

-Allahu i mëshiroftë!-, ngase shkresa përbën shkronja që prej tyre kuptohet divorci, e i ngjason shqiptimit, ngase shkrimi merr pozitën e fjalës së shkruarit, duke u argumentuar se Profeti, *-sal-lallahu alejhi ue selem-*, ka qenë i urdhëruar për të kumtuar mesazhin, e këtë herë e bënte me fjalë, e herë me

shkresë. Mirëpo, po që se shkruhet divorci, mirëpo nuk bëhet nijet për atë divorc, atëherë nuk vlen.

Ibën Kudame, -Allahu e mëshiroftë!-, në "El-Mugni" 10/504, ka thënë: "Në qoftë se shkresa është pa nijet, në një prej dy transmetimeve nga Ahmedi: vlen; e ky është opinionimi i Shabiut, Nahaiut, Zuhriut;

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

e dispozita është ajo që kemi përmendur.

E dyta është që nuk vlen përveçse me niset; ky qëndrim është i Ebu Hanifës, Malikut dhe citohet për Shafiun; ngase e shkruara është e mundshme të kuptohet në disa mënyra; ndoshta ai ka për qëllim të provojë stilolapsin, të zbukurojë shkrimin apo ta mërzitë familjen; pra nuk vlen nëse është pa niset”.

Shih: “Bedaius-Sanai” (4/239), “Esh-Sherhul-Kebir” (2/384), të Durdejrit; “Mugnil-Muhtaxh” (3/284), “El-Insaf” (22/230).

E nga kjo, pra divorci nuk bie nëse bëhet në gjyq me shkresë në letër, përderisa ai nuk ka për qëllim divorcin.

Është obligim për muslimanin ku do që të gjendet të jetë besnik dhe i vërtetë me fjalët, veprat, raportet dhe sjelljet e tij me të tjerët, edhe po qe se bëhet fjalë për me jomuslimanë, e atij s’i lejohet gënjeshtria dhe mashtrimi, ngase këto janë prej mëkateve të mëdha. I Dërguari, *-sal-lallahu alejhi ue selem-*, ka thënë: *“Katër veti po u gjetën tek një individ, i tillë është hipokrit i vërtetë; e nëse ka vetëm një ves prej tyre, atëherë ka një ves të hipokrizisë derisa ta braktisë të njëjtën: kur i besohet- tradhton, kur flet- gënjen, kur premtton- thyen fjalën, e kur hasmëron- shthuret”* Transmetojnë Buhariu (34) dhe Muslimi (58). Gjithashtu, Profeti, *-sal-lallahu alejhi ue selem-*, ka thënë: *“Kush mashtron, ai s’është prej nesh”* Muslimi (102).

Dredhitë ndaj sistemit me pretendim të divorcit me qëllim të arritjes së përfitimeve materiale, në këtë rast të apartamentit dhe pagës, janë mashtrim, rrenë dhe falsifikim të cilat vepra nuk lejohen, edhe nëse është në shtet jobesimtar, për sa kohë që jeton në atë

vend me mbrojtje zyrtare nga shteti.

Përderisa ato shtete e sigurojnë, e mbrojnë dhe i ruajnë pasuritë e tij, obligimi i tij është të jetë i besueshëm karshi atij shteti, ndaj s’i lejohet tradhtia dhe mashtrimi.

Imam Shafiu, *-Allahu e mëshiroftë!-*, ka thënë: *“Kur një popull prej muslimanëve hyjnë në Biladul-Harb (shtetet e jobesimtarëve) me sigurim, armiku i tyre është i sigurt derisa të largohen prej tyre apo t’i kumtojnë përgjatë qëndrimit të tyre, e, padrejtësia dhe mashtrimi assesi s’u përkasin”.* “El-Um” (4/263)

Obligimi i atyre që jetojnë në shtetet e jomuslimanëve është t’i përkushtohen Sheriatit të Allahut dhe të stolisen me edukatën islame dhe moralet e saj të çmuara, në mënyrë që t’i shfaqin jomuslimanëve vlerën dhe madhësitinë e Islamit e të marrin ata një përshtypje të mirë, e jo të kundërshtojnë udhëzimet islame e të shkelin në atë çka ka ndaluar, e kësisoj të dëmtojnë vetën dhe Islamin. Allahu e di më së miri!

Pyetje: Unë punoj në një kompani; dhe nga vështirësitë aty është tek puna e abdesit për namaz, pra nuk mund të heq hixhabin për t’i prekur flokët dhe veshët. Dhe pyetja është: A është më mirë të jap mes’h mbi hixhab e të prek veshët veç me aq mundësi sa kam, apo t’i bashkoj namazin e drekës dhe të ikindisë në shtëpi?!

Përgjigje: Ajo që duket se çka të pengon për të hequr hixhabin, është prezenca e burrave të huaj në vendin e punës tënde, e nëse çështja është e këtillë dije se përzierjes së gruas me burra të huaj i radhiten dëme dhe rreziqe të shumta, si

vetmimi, shikimi, biseda, shqetësim të zemrës, e të tjera që nuk i fshihen mendjemprehtëve.

Së dyti, kush është sprovuar me këtë, e hyn koha e namazit përgjatë kohës që është në punë e nuk ka mundësi ta shtyjë faljen e namazit derisa të kthehet në shtëpi, atëherë ajo falet në vendin më të mbuluar në vendin e punës.

Së treti, fjala jote: “dhe nga vështirësitë aty është tek puna e abdesit për namaz, pra nuk mund të heq hixhabin për t’i prekur flokët dhe veshët.” rrjedhë pyetja: atëherë si i lanë krahët dhe këmbët në prezencë të burrave?! E, ti e di se krahët dhe këmbët janë prej avretit çka obligohet mbulimi i tyre prej të huajve.

Së katërti, i lejohet gruas të jep mes’h mbi shaminë e saj në rast nevoje, si p.sh. ftohti i madh apo vështirësitë në heqjen dhe veshjen e hixhazit.

Ibën Uthejmini, -Allahu e mëshiroftë!-, është pyetur: “A i lejohet gruas të jap mes’h mbi shaminë e saj?”, e u përgjigj:

“Më e njohura nga medh’hebi i Imam Ahmedit është se ajo mund t’i japë mes’h shamisë atëherë kur rrethi është ndër fyt, ngase kjo është përmendur nga disa gra të sahabëve, -Allahu qoftë i kënaqur me to!-. Sidoqoftë, në qoftë se ka vështirësi, o për shkak të ftohtit apo për shkak të telasheve në heqjen dhe mbështjelljen e hixhazit, kësioj raste s’ka gjë, megjithëse më parësore është të mos i biesh mes’h”. “Fetava el-tahareh”, f. 171

Kurse në “Sherh munteha el-iradat”, (1/60), ka thënë: “I vlefshëm është mes’hu mbi shami atëherë kur rrethi është ndër fyt, ngase Umu Selemeja i jepte mes’h shamisë së saj. Ibën Mundhiri e ka përmendur”.

Përderisa shamia i mbulon dy veshët,

atëherë mjafton mes’hi mbi shami, e nuk patjetërsohet futja e duarve për t’iu dhënë mes’h, kësioj qëndron edhe kur njeriu vesh çallmën (imamen), ai nuk është i obliguar t’u jep mes’h veshëve, edhe nëse janë të zbuluar, madje veç pëlqehet diç e tillë.

Së pesti, gruaja muslimane duhet të ketë përkujdesje për devocionin ndaj Zotit, nënshtrimin ndaj urdhrave të Tij, shmangies nga ndalesat e Tij, largimin prej punëve ku ka përzierje, ndaj të cilave ndodh të bie zemërimi i Allahut; të jetë syçelë, të mos i jep përparësi dynjasë, përpara ahiretit, ngase kjo jetë është kënaqësi e përkohshme, e çka është tek Allahu nuk ka të sosur. Është vërtetuar se i Dërguari i Allahut, -sal-lallahu alejhi ue selem-, ka thënë: “Kush lë diçka për hir të Allahut, ia kompenson me më të mirë se ajo”. Shejh Albani, e ka bërë sahih, në “Hixhabul-mer’etil-muslimeh”, f.49.

Lusim Allahun të të japë sukses në atë që është më e dobishme për ty në dynja e ahiret. Allahu e di më së miri!

Pyetje: Ankoem prej një sëmundje në sistemin digjektiv dhe për këtë kurohem tek një mjek i krishterë prej më se dy muajsh për afërsisht, ngase nuk njihja tjetër mjek përveç tij derisa njoha një mjek musliman, tani a të largohem nga mjeku i krishterë e të shkoj tek mjeku musliman apo të mbes tek mjeku i krishterë për ta kompletuar kurën?!

Përgjigje: Lavd-falënderimi i takon Allahut!

Nëse ky mjeku i krishterë është besnik dhe i zoti në mjekësi, e ti ke filluar me të, nëse sheh tek ai avancim e punë të mirë, s’është problem të vazhdosh me të, e nuk

e ke patjetër ta lësh e të shkosh tek mjeku musliman.

Me të vërtetë, mjeku ekspert, edhe nëse nuk është musliman, mund të harxhojë mund, kohë e pasuri të madhe për ty, e mbase Allahu e shkruan shërimin të ndodh tek sa kurohesh tek ai.

Muslimanët në të kaluarën, e po edhe sot akoma kërkojnë ndihmë mjekësore nga mjekët, po edhe nëse janë jomuslimanë.

İbën Mukriu ka transmetuar në “Muëxhem”, (352) nga Mubarek İbën Seid, që ka thënë: Së pari kur Sufjan Thevriu filloi asketizmin, kishte mendim se është i sëmurë; atëherë urinën e tij e morëm në shishe, e shkuam tek një mjek i krishterë, e ai na tha: ‘shoku juaj nuk është i sëmurë, s’ka gjë tjetër veçse frikë, e kjo nuk është veçse urinë murgu’.

Meruvdhiu ka thënë: “Kam parë një mjek të krishterë tek del nga Imam Ahmedi e me të ishte një murg, e tha: Ai më kërkoi të vijë me mua për ta parë Ebu Abdullahun”. “Sijer ealemi en-nubelai” (11/211)

İbën Kajjimi, -Allahu e mëshiroftë!-, ka thënë: “Kur Profeti, -sal-lallahu alejhi ue selem-, e pagoi Abdullah İbën Urejkit el-Dejliun që ta shoqërojë për t’i treguar udhën në kohën e hixhretit, këtu ka argument për lejueshmërinë për t’u referuar tek jobesimtari në mjekësi, ilaçe, shkresa, kalkulime, defekte e të ngjashme si këto, përderisa nuk është afrim miqësie, ngase veç të qenit e tij jobesimtar nuk na detyron ne esencë të mos i zëmë besë në diçka, ngase s’ka gjë më të rrezikshme, se sa shoqërimi në rrugë për të ta treguar udhën, e aq më tepër në rastin në fjalë në udhën e hixhretit”. “Bedaiul-fevaid” (3/725)

İbën Muflihu, duke përcjellë nga Shejhul Islam İbën Tejmije, ka thënë: “Kur hebreu apo i krishteri është ekspert në mjekësi dhe i besueshëm tek njerëzit, i lejohet atij të kërkojë intervenim mjekësor, të deponojë pasuri e të ketë raporte me të, ashtu siç ka thënë Allahu i Lartësuar: **“Ka edhe aso ithtarësh të Librit, që sikur t’u besosh një barrë të tërë ari, do t’jua kthejnë, por ka edhe të atillë që nëse ua jep në besim, qoftë edhe një dinar, nuk ta kthen”** (Ali İmran: 75)

E, po qe se i mundësohet atij të kërkojë mjekim nga muslimani, çështja qëndron sikur në çështjen e deponimit të raporteve, e nuk i takon t’i barazojë, porse nëse ka nevojë për kërkim të mjekimit dhe ka besë tek *kitabiu*, atëherë i takon kjo, porse pa ra në atë afërsinë e ndaluar ndaj hebreut dhe të krishterit, e nëse bisedon me atë që është më e mirë, kjo është diçka e mirë”. “El-Edab el-Sher’ijeh” (3/76)

Shejh İbën Uthejmini, -Allahu e mëshiroftë!-, është pyetur: “A i lejohet gruas muslimane të kurohet tek një grua e krishtere?”, e ai u përgjigj:

“Nëse i zë besë, atëherë s’ka problem; e argument për këtë kemi se i Dërguari, -sal-lallahu alejhi ue selem-, kur udhëtoi prej Mekës për në Medinë në hixhret, e shfrytëzoi një burrë mushrik, që e quanin Abdullah İbën Urejkit prej bijve të Ed-Dejl, që t’i tregojë udhën”. “Likaul-babil-meftuhe” (2/56). Lusim Allahun për ju që t’ju shëroje e japë shëndet të plotë! ■

Nga arabishtja: M. Maliqi